

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5523  
E mërkurë, 11 korrik 2018  
çmimi 0.40 €

## Haradinaj kërkon ndihmën e Merkelit për vizat, dialogun dhe formimin e ushtrisë



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", DHURATA HOXHA

## Rekomandimi për liberalizimin e vizave, para pushimeve

- Presim rekomandim pozitiv nga  
Komisioni Evropian ngaqë Kosova ka  
punuar për përmbushjen e kriterëve


Ministrja e Integritimit Evropian,  
Dhurata Hoxha, ka bërë me dije  
se Komisioni Evropian do ta pub-  
likojë rekomandimin për liberal-  
izimin para pushimeve verore.  
Ajo ka thënë se institucionet e  
Kosovës presin që rekomandimi  
për vizat të jetë pozitiv meqë  
janë plotësuar të gjitha kriteret e  
nevojshme. Në këtë intervistë  
dhënë për gazetën "Epoka e re",

Hoxha ka paralajmëruar se pas  
marrjes së rekomandimit për  
viza do të lansohet fushata që ka  
për qëllim informimin e qytet-  
tarëve për të mos e keqpërdorur  
liberalizimin e vizave. Ajo ka  
thënë se Kosova ka arritur të vë  
në kontroll migrimin dhe, sipas  
Hoxhës, vendi ynë ka statistikat  
më të ulëta jo vetëm në rajon,  
por edhe më gjerë



### AKTUALE

#### IMPAKTI GJEOPOLITIK I MARRËVESHJES GREQI - MAQEDONI



Profesor Dr. Blerim REKA

#### NUK ËSHTË HASHIM THAÇI AS DE KLERK E AS MENDELA QË TË VENDOSË PËR AMNISTI PËR KRIME LUFTË



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

#### PAQARTËSI RRETH KOSTOS SË FINANCIMIT PËR PUNËTORËT E ARSIMIT TË VITEVE '90


### EKONOMI

#### 1.2 MILION EURO DËMET NGA TË RESHURAT

#### BANKA BOTËRORE, PROJEKT PËR PUNËSIMIN E TË RINJVE

### SPORT

#### RONALDO NËNSHKRUAN ME JUVENTUSIN



#### MË 28 KORRIK NDESHJA E PARË NË STADIUMIN E PRISHTINËS



## Presioni ndërkombëtar pritet ta shtyjë përpara konsensusin kombëtar

Njohësit e proceseve politike në  
vend presin të shtohet presioni  
ndërkombëtar mbi subjektet politike  
për arritjen e një konsensusi  
kombëtar për fazën përfundimtare të  
dialogut me Serbinë. Imer Mushkolaj  
dhe Behxhet Shala kanë bërë me dije

për gazetën "Epoka e re" se duhet të  
ketë një pajtueshmëri mes partive  
për disa çështje. Sipas tyre, tryezat e  
deritanishme të partive politike rreth  
arritjes së një konsensusi kanë qenë  
të dështuara për faktin se nuk kanë  
sjellë asnjë rezultat

## 60 persona kanë humbur jetën në komunikacionin rrugor për gjashtë muaj

Bazuar në të dhënat e fundit për gjendjen  
aktuale në trafikun rrugor, vetëm në javën  
e kaluar kanë humbur jetën gjashtë qytet-  
tarë të Kosovës si rezultat i fatkeqësive në  
trafik. Sipas statistikave të Policisë së

Kosovës në periudhën janar - qershor të  
këtij viti, 60 persona kanë humbur jetën si  
pasojë e aksidenteve në komunikacionin  
rrugor dhe 5 629 persona janë lënduar,  
disa prej tyre janë në gjendje të rëndë



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijibiznesi.com  
info@kolegijibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## NATO-ja mbështet formimin e ushtrisë së Kosovës

BRUKSEL, 10 KORRIK - Zëvendëssekretarja e përgjithshme e NATO-s, Rose Gottemoeller, ka thënë se kjo organizatë mbështet formimin e ushtrisë së Kosovës dhe se ky proces duhet të zhvillohet në pajtim me Kushtetutën. "Është e rëndësishme që Kosova ta

vazhdojë procesin e reformave që përfshinë formimin e forcave profesionale të sigurisë. Do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me zyrtarët e Kosovës dhe ta mbështesim misionin e KFOR-it në Kosovë. Mendoj se është e rëndësishme që nga baza në Bondstil të mbahet siguria në

rajon dhe të ndihmohet në formimin e ushtrisë profesionale të ushtrisë së Kosovës", ka thënë Gottemoeller në prag të Samitit të NATO-s në Bruksel.

Gottemoeller thotë se anëtarësimi i Maqedonisë do të ndihmojë në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor.



# Haradinaj kërkon ndihmën e Merkelit për vizat, dialogun dhe formimin e ushtrisë

Në takim ndërmjet kryeministrit Haradinaj dhe kancelares Merkel është biseduar për marrëdhëniet bilaterale ndërmjet dy shteteve për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit me shtetin gjerman, për proceset e përgjithshme në Kosovë, për përmbushjen e obligimeve të Kosovës në raport me BE-në, si dhe për procesin e finalizimit të dialogut me Serbinë

PRISHTINË, 10 KORRIK - Gjatë vizitës zyrtare në Mbretërinë e Bashkuar, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të martën ka zhvilluar takim bilateral me kancelaren e Gjermanisë, Angela Merkel. Në takim ndërmjet kryeministrit Haradinaj dhe kancelares Merkel është biseduar për marrëdhëniet bilaterale ndërmjet dy shteteve, për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit me shtetin gjerman, për proceset e përgjithshme në Kosovë, për përmbushjen e obligimeve të Kosovës në raport me BE-në, si dhe për procesin e finalizimit të dialogut me Serbinë.

Siç njofton zyra e kryeministrit, Haradinaj vlerësoi rolin e jashtëzakonshëm të Gjermanisë në proceset jetike të shtetndërtimit të Kosovës. "Partneriteti

strategjik ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë është i një rëndësie të veçantë, duke njohur rolin dhe kontributin e Gjermanisë edhe në procesin e Berlinit për vendet e Ballkanit Perëndimor, e cila i ka hapur rrugë Kosovës që të trajtohet në mënyrë të barabartë me vendet e tjera të rajonit. Kosova është e përkushtuar ta avancojë këtë partneritet. Parku Inovativ dhe Trajnues në Prizren është një dëshmi e radhës që vendi ynë është i përkushtuar për praninë ekonomike krahas asaj politike", tha kryeministri Haradinaj.

Duke falënderuar kancelaren Merkel për mbështetjen e fuqishme të saj dhe të shtetit gjerman, kryeministri Haradinaj tha se Qeveria e Kosovës me përkushtim dhe vendosmëri të lartë është duke luftuar krimin e



organizuar dhe korrupsionin, duke e fuqizuar sundimin e rendit dhe ligjit, duke i dhënë prioritet zhvillimit ekonomik, agjendës së reformave evropiane dhe normalizimit të plotë të marrëdhënieve me fqinjët. "Lidershipi juaj ka qenë vendimtar për shumë procese nëpër të cilat po kalon Ballkani

Perëndimor, andaj kërkojmë mbështetjen tuaj që edhe në këtë fazë të rëndësishme të procesit të integriteteve evropiane, liberalizimit të vizave, të jeni zë i fuqishëm për të ardhmen prosperuese të Kosovës", tha kryeministri Haradinaj. Kancelarja gjermane Angela Merkel tha se Gjermania përmes

procesit të Berlinit do ta luajë rolin e saj edhe më tutje që Kosova të jetë e barabartë dhe të jetë kontribuuese në stabilitetin politik jo vetëm të saj, por edhe të rajonit. Në takim ndërmjet kryeministrit Haradinaj me kancelaren Merkel i pranishëm ishte edhe zëvendëskryeministri dhe ministër i Jashtëm, Behgjet Pacolli.

## Bushati: Marrëveshja me Greqinë, në një të ardhme të afërt

TIRANË, 10 KORRIK - I pranishëm në Samitin e Londër, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, foli për marrëveshjen me Greqinë. Ai theksoi se takimi Rama - Tsipras është mundësi e artë për t'i përcaktuar linjat e drejtimit që duhet të jepen në këtë proces. "Ne kemi bërë hapa të qëndrueshëm përpara për sa iu përket bisedimeve për një marrëveshje të re për kufizimin e zonave detare, një marrëveshje e re që do të udhëhiqet nga

parimet e së drejtës ndërkombëtare publike, në fushën e detit por, para së gjithash, një marrëveshje e re e cila do të ishte e drejtë dhe e zbatueshme për dy vendet tona. Nuk është një proces i lehtë, ka rezistencë politike në të dyja anët, qoftë në Shqipëri ashtu dhe në Greqi, por besojmë se me vendosmëri dhe vullnet politik të qartë ne në një të ardhme të afërt do të kemi produktet konkrete, qoftë për këtë marrëveshje ashtu edhe për pjesën tjetër që përbëjnë ele-



mentët e paketës që ne po diskutojmë me Greqinë", tha Bushati.

Ministri tha se rezistenca ka të bëjë më tepër me qëndrime politike si në Shqipëri dhe në Greqi duke u shprehur se seg-

mente të caktuara ose preferojnë status quo ose janë kundër një perspektive të përbashkët evropiane të Shqipërisë dhe Greqisë.

Ministri i Jashtëm theksoi edhe një herë se përtej afateve që janë folur për përfundimin e marrëveshjes së rëndësishme për momentin që flasim është cilësia e punës së grupeve dhe vetë procesit. "Është folur shpesh për afate, u përcaktua pranvera, fillimi i verës, vera, vjeshta. Afatet janë shumë të rëndësishme

sepse janë një mundësi për t'i mbajtur të motivuara ekipet respektive që punojnë dita-ditës për të gjitha marrëveshjet që janë në tryezë, por është më e rëndësishme në këtë moment që flasim, cilësia e punës dhe cilësia e këtij procesi. Besojmë se ndajmë të njëjtin mendim edhe me palën greke, që nuk duhet humbur kohë në këtë proces, sepse problematika tashmë është mbi 70-vjeçare, e stërnjohur dhe të gjitha opsionet janë shqyrtuar në tryezë", tha Bushati.



Analistët politikë nuk presin rezultate nga tryezat e partive politike për temat e mëdha

# Presioni ndërkombëtar pritet ta shtyjë përpara konsensusin kombëtar



Njohësit e proceseve politike në vend presin të shtohet presioni ndërkombëtar mbi subjektet politike për arritjen e një konsensusi kombëtar për fazën përfundimtare të dialogut me Serbinë. Imer Mushkolaj dhe Behxhet Shala kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se duhet të ketë një pajtueshmëri mes partive për disa çështje. Sipas tyre, tryezat e deritanishme të partive politike rreth arritjes së një konsensusi kanë qenë të dështuara për faktin se nuk kanë sjellë asnjë rezultat

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 10 KORRIK** - Njohësit e rrethanave politike në vend kanë paralajmëruar shtimin e presionit ndërkombëtar ndaj subjekteve politike për arritjen e konsensusit kombëtar rreth fazës finale të dialogut me Serbinë. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se pajtueshmëria e partive politike për këtë proces është e nevojshme. Sipas tyre, qëllimisht partitë politike nuk kanë dashur të arrijnë ndonjë konsensus kombëtar për këtë çështje në tryezat e organizuara deri më tani. Analisti politik Imer Mushkolaj ka deklaruar se presioni ndërkombëtar do ta bëjë pjesë të procesit LDK-në. "Presioni ndërkombëtar veçse ka filluar. Presioni

ndërkombëtar do të bëhet edhe më i fortë me kalimin e javëve. Është i domosdoshëm të arrihet një pajtim më i madh në këtë proces. Pavarësisht prej deklarimeve që janë për konsum të brendshëm, pres që LDK-ja së shpejti të bëhet pjesë e procesit. Z. Mustafa si kryetar i LDK-së me muaj është i informuar prej dorës se parë se çfarë po ndodh, kështu që besoj se LDK-ja do të bëhet pjesë e procesit. Nuk pres që pjesë e këtij procesi të bëhen të gjitha partitë politike, sepse nuk është e mundur. Por, do të arrihet njëfarë konsensusi që shumica e spektrit politik ta përkrahë dialogun", ka thënë Mushkolaj. Sipas tij, opozita duhet të bëhet pjesë e këtij procesi sepse dialogu me Serbinë nuk është çështje e vetëm një individi. "Besoj se konsensusi për

fazën finale do të arrihet. Nëse nuk arrihet tash, kjo do të ndodhë deri në shtator, sepse kemi të bëjmë me një proces tepër të rëndësishëm dhe nuk është zgjidhje tërheqja prej procesit të dialogimit. Zgjidhje është pjesëmarrja në këtë proces. Tekefundit, dialogu nuk është çështje private e Hashim Thaçit. Çfarëdo marrëveshje që arrihet në këtë proces, qoftë për mirë apo për keq, pasojat do t'i bartin qytetarët e Kosovës", ka thënë Mushkolaj. Ndërsa analisti tjetër politik Behxhet Shala mendon se bashkësia ndërkombëtare tashmë është shumë aktive në këtë proces. Sipas tij, partnerët ndërkombëtarë janë duke e mbështetur presidentin si prijës të dialogut. "Bashkësia ndërkombëtare është pjesë e këtij procesi, sepse bashkësia ndërkombëtare është përcaktuar për presidentin Thaçi si udhëheqës i këtij dialogu. Ata kanë deklaruar se nuk janë të interesuar të fusin lojtar të ri në dialog. Po ashtu, edhe Serbia nuk është e interesuar të fusë lojtar të ri në dialog. Pra, të gjithë ndërkombëtarët po pajtohen që Vuçiqi dhe Thaçi të jenë aktorët që do t'i prijnë dialogut dhe do ta përmbyllin marrëveshjen përfundimtare. Ndërsa nëse opozita pajtohet që të jetë pjesë e këtij procesi, do të luajë një rol dytësor", ka thënë Shala, duke shtuar se fjalën kryesore për Kosovën në

këtë proces do ta ketë presidenti Thaçi, sikurse që Vuçiqi do ta ketë për Serbinë.

Ndër të tjera, Shala ka vlerësuar se Kuvendi i Kosovës duhet të jetë i inkuadruar drejtpërdrejt në këtë proces. "Nëse Thaçi e fiton mbështetjen nga Kuvendi i Kosovës atëherë askush nuk mund ta kontestonte rolin e tij si kryenegociator. Mirëpo edhe në këtë rast Kuvendi do të duhej ta monitoronte punën e tij në këtë proces. Kuvendi do të duhej të jetë aktor vendimmarrës për këtë proces ngaqë Kosova nuk është republikë presidenciale, por republikë parlamentare dhe Kuvendi duhet të jetë alfa dhe omega e të gjitha zhvillimeve politike që kanë të bëjnë për Kosovën", është shprehur Shala.

## Tryezat politike, të dështuara

Njohësit e proceseve politike i kanë komentuar edhe tryezat e partive politike të cilat janë organizuar deri më tani, me synimin për të arritur një konsensus kombëtar për temat e mëdha. Sipas tyre, këto tryeza kanë qenë një dështim për faktin se vet subjektet politike kanë dashur të jenë kështu. "Tryezat e partive politike kanë qenë një arsye për mosarritje të marrëveshjeve. Konsensusi për temat e mëdha është dashur të arrihet në Kuvend dhe jo nëpër

tryeza të partive politike. Në vend se të kundërshtohet arritja e konsensusit dhe apriori të kundërshtohet Hashim Thaçi si udhëheqës i këtij proces, do të ishte mirë që partitë politike të bëhen pjesë e këtij procesi dhe ta japin kontributin e tyre në mënyrë që mos ta lejojnë presidentin të gabojë", ka thënë analisti Imer Mushkolaj. Kurse analisti Behxhet Shala ka thënë se asnjë subjekt politik në vend nuk është i interesuar të arrijë një konsensus për një çështje të caktuar. "Këto kanë qenë takime vetëm sa për të fituar kohë. Pozita vazhdimisht po mundohet ta joshë opozitën me një ofertë që ta përkrahë Thaçin si kryenegociator, ndërsa opozita, LDK-ja dhe LV-ja, po kërkojnë zgjedhje të reja apo caktimin e datës së zgjedhjeve si mënyrë më të mirë për të dalë nga kjo situatë. Asnjëra palë nuk është e interesuar për zgjedhje të reja, as pozita dhe as opozita. Thjesht, këto subjekte politike vetëm po mundohen të përfitojnë në kohë. Deri tash asnjë takim nuk ka dhënë rezultat dhe nuk pres që as në të ardhmen të japë ndonjë rezultat", është shprehur Shala. Me vetiniciativë, subjektet politike deri më tani kanë mbajtur disa tryeza politike, duke synuar arritjen e një konsensusi për disa çështje madhore, por deri më tani nuk është arritur ndonjë rezultat në këtë drejtim.



Flet për "Epokën e re", Dhurata Hoxha

# Rekomandimi për liberalizim

## - Presim rekomandim pozitiv nga Komisioni Evropian ngaqë Kosova ka punuar për përmbushjen e kriterëve

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se Komisioni Evropian do ta publikojë rekomandimin për liberalizimin para pushimeve verore. Ajo ka thënë se institucionet e Kosovës presin që rekomandimi për vizat të jetë pozitiv meqë janë plotësuar të gjitha kriteret e nevojshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxha ka paralajmëruar se pas marrjes së rekomandimit për viza do të lansohet fushata që ka për qëllim informimin e qytetarëve për të mos e keqpërdorur liberalizimin e vizave. Ajo ka thënë se Kosova ka arritur të vë në kontroll migrimin dhe, sipas Hoxhës, vendi ynë ka statistikat më të ulëta jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 10 KORRIK** - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë të martën se janë në pritje të rekomandimit pozitiv për liberalizimin e vizave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka bërë me dije se vendimi për vizat do të merret para pushimeve të verës. "Ne presim rekomandim pozitiv ngaqë Kosova ka punuar për plotësimin e kriterëve dhe tani presim të ketë një vendim para pushimeve të verës", është shprehur Hoxha, duke shtuar se tashmë Kosova ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara për këtë proces. "Pjesa e punës sonë është finalizuar sipas afateve të parapara, pra të gjitha 95 kushtet për liberalizim nga udhërrëfyesi janë përmbushur. Procesi është në duar të vendimmarrësve evropianë, në rend të parë të Komisionit për Migrim dhe Çështje të Brendshme. Ne presim një proces të drejtë dhe të barabartë sikurse edhe vendet e tjera të rajonit që kanë kaluar nëpër këtë proces", ka theksuar ministrja Hoxha.

Ajo ka paralajmëruar se pas marrjes së rekomandimit për viza do të lansohet fushata që ka për qëllim informimin e qytetarëve për të mos e keqpërdorur liberalizimin e vizave. "Po, ne jemi gati ta fillojmë këtë proces sa më shpejt dhe në mbarë Kosovën, duke përfutur të gjithë qytetarët nga lëvizja e lirë dhe duke mos lejuar keqpërdorimin e liberalizimit. Ne do të ndërmarim veprime informuese gjithëpërfshirëse me të gjitha institucionet e vendit, së bashku me mediet dhe shoqërinë civile", ka treguar Hoxha. Sipas saj, Kosova ka arritur ta vë në kontroll migrimin dhe ka statistikat më të

ulëta jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë.

Ministrja Hoxha ka shprehur përkushtimin e institucioneve për përshpejtimin e reformave të agjendës për integritet evropian. "Ne nuk kemi kohë për të humbur dhe nuk guxojmë të lejojmë grumbullimin e realizimit të obligimeve tona në proces. Për shtator jemi përkushtuar që të gjitha veprimet që dalin nga ERA të përfundojnë që përkon edhe me mundësinë e vizitës nga komisionari Hahn. Integritimi në vlerat evropiane nuk është proces i njehershëm, por i vazhdueshëm. Deri në shtator duhet t'i përfundojmë detyrimet tona ndërkombëtare për ERA-n", ka thënë ajo, duke shtuar se procesi i zbatimit të MSA-së duhet të vijojë me dinamikë të re si proces prioritar qeveritar për t'iu bashkuar sa më parë familjes dhe vlerave evropiane.

**"Epoka e re":** Znj. Hoxha, në fillim të këtij muaji është pritur se Komisioni Evropian do ta publikojë rekomandimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende. Mund të na tregoni çfarë është duke ndodhur me këtë proces?

**Hoxha:** Pjesa e punës sonë është finalizuar sipas afateve të parapara, pra të gjitha 95 kushtet për liberalizim nga udhërrëfyesi janë përmbushur. Procesi është në duar të vendimmarrësve evropianë, në rend të parë të Komisionit për Migrim dhe Çështje të Brendshme. Presim një proces të drejtë dhe të barabartë sikurse edhe vendet e tjera të rajonit që kanë kaluar nëpër këtë proces.

**"Epoka e re":** Çështja e emigrantëve a mund të ndikojë në





# in e vizave, para pushimeve

shtyrjen e procesit të liberalizimit?

**Hoxha:** Debatimi që po zhvillohet në vendet anëtare të BE-së për migrimin patjetër që është një çështje shumë e rëndësishme për këto vende. Ne i kuptojmë shqetësimet e tyre, por Kosova është shtet i sigurt i origjinës dhe ne kemi punuar shumë dhe kemi legjislacionin sipas praktikave më të mira të vendeve të BE-së, institucione të kualifikuara për zbatimin e legjislacionit si dhe fushatat vetëdijesuese kundër migrimit ilegal duke e penguar me mjete ligjore. Tashmë kjo dukuri e perceptimit negativ ndaj vendit tonë është ndalur. Kosova ka arritur ta vë në kontroll migrimin dhe kemi statistikën më të ulëta jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë.

**"Epoka e re":** Duke u bazuar në punën që kanë bërë institucionet e Kosovës, prisni që rekomandimi të jetë pozitiv?

**Hoxha:** Presim rekomandim pozitiv ngaqë Kosova ka punuar për plotësimin e kriterëve. Tani presim të ketë një vendim para pushimeve të verës. Ne si institucione jemi të përkushtuar dhe të angazhuar që reformat e agjendës së integritimit evropian të vazhdojnë dhe të përshpejtohen pavarësisht prej procesit të liberalizimit të vizave.

**"Epoka e re":** Pasi Kosova ta marrë liberalizimin, do të nisë ndonjë fushatë Ministria e Integritimit Evropian për t'ua shpjeguar qytetarëve rregullat që duhet t'u përmbahen?

**Hoxha:** Po, ne jemi gati të fillojmë këtë proces sa më shpejt dhe në mbarë Kosovën, duke përfutur të gjithë qytetarët nga lëvizja e lirë dhe duke mos lejuar keqpërdorimin e liberalizimit. Ne do të ndërmarrim veprime informuese gjithëpërfshirëse me të gjitha institucionet e vendit, së bashku me mediet dhe shoqërinë civile.

**"Epoka e re":** Ministre, ju keni kërkuar nga ministratë përkatëse me shumë angazhim për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) deri në muajin shtator. Ka shanse që deri në këtë afat kohor të përfundojë ERA?

**Hoxha:** Ne kemi afatet për zbatimin e Agjendës Evropiane të Reformave, të ndara nëpër

institucione, duke ndjekur secilin kapitull, secilin segment të veprimtarisë institucionale në vend. Ne nuk kemi kohë për të humbur dhe nuk guxojmë ta lejojmë grumbullimin e realizimit të obligimeve tona në proces. Për shtator jemi përkushtuar që të gjitha veprimet që dalin nga ERA të përfundojnë, që përkon edhe me mundësinë e vizitës nga komisionari Hahn. Integrimi në vlerat evropiane nuk është proces i njëhershëm, por i vazhdueshëm. Deri në shtator duhet t'i përfundojmë detyrimet tona ndërkombëtare për ERA-n. Ndërsa procesi i zbatimit të MSA-së duhet të vijojë me dinamikë të re si proces prioritar qeveritar për t'iu bashkuar sa më parë familjes dhe vlerave evropiane.

## Qeveria shihet si nxitëse e grevave të punëtorëve

PRISHTINË, 10 KORRIK - Muajt dhe javët e fundit shumë ndërmarrje publike në Kosovë janë përfshirë në greva. Pakënaqësitë e punëtorëve besohet se janë të akumuluara përgjatë viteve. Gjatë vitit 2018 përmes grevave e protestave të ndryshme kishin shprehur apo edhe po shprehin pakënaqësitë mjekët, mësimit-hënësit, punëtorët e Postës së Kosovës, punonjësit në administratën e gjykatave e prokurorët dhe minatorët e "Trepçës". Arsyet e grevave të punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve, përkatësisht kompanive, kryesisht kanë të bëjnë me pakënaqësitë e tyre me pagat dhe shërbimet e tjera. Minatorët e kombinatit "Trepça" janë duke vazhduar grevën në të cilën kanë hyrë të hënën. Kërkesat sociale të minatorëve të "Trepçës" janë njohja e stazhit të benificuar të punës, siguria shëndetësore në punë, rritja e pensioneve dhe disa kërkesa të tjera. Qazim Jashari, menaxher në minierën e Stantërgut në Mitrovicë, bën të ditur për "Radion Evropa e Lirë" se kërkesat e tyre datojnë që nga pas lufta por që, si të tilla, nuk janë realizuar deri më tani. "Kjo pakënaqësi ka ardhur duke u rritur. Kërkesat e minatorëve janë tani e 19 vjet dhe askush, asnjëra prej qeverive të deritashme, nuk ka tentuar ta rregullojë gjendjen. Minatorët janë në gjendje të

keqe, 'Trepça' është në gjendje të keqe. Minatorët mendojnë që kjo 'Trepçë' të rritet mirëpo, sipas rrethanave të tashme, ky kombinat po shuhet", ka thënë Jashari.

Tani afër dy vjet nga miratimi i Ligjit për Trepçën institucionet e vendit nuk kanë arritur t'i përfundojnë të gjitha procedurat të cilat nevojiten për funksionalizimin dhe ringjalljen e këtij kompleksi. Ndërkaq përfaqësues të mekanizmave që mbrojnë të drejtat e punëtorëve në Kosovë flasin për gjendjen e rëndë të punëtorëve në përgjithësi.

Avni Ajdini, kryetar i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë,

ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se grevat kanë ardhur si pasojë e pakënaqësive të mëdha që kanë punëtorët me pagat. "Pas luftës menjëherë ka pasur premtime të mëdha nga partitë politike, por ato nuk janë realizuar dhe si pasojë tani ka ardhur deri te fundi, që do të thotë se punëtorët janë në krizë ekonomike dhe kërkojnë realizimin e të drejtave të tyre", ka deklaruar Ajdini. Sipas tij, grevat janë nxitur nga qeveritë për shkak të mospërmbushjes së premtimeve që ata kanë bërë në vazhdimësi. "Punëtorët i ka nxitur Qeveria të bëjnë një gjë të tillë për shkak se Qeveria i ka degraduar dhe nënçmuar. Premtimet kanë qenë të

mëdha dhe deri më tani asnjë premtim dhe asnjë marrëveshje që ka qenë ndërmjet Qeverisë dhe BSPK-së nuk është realizuar nga Qeveria", është shprehur Ajdini.

Në një hulumtim të publikuar ditë më parë nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) thuhet se kënaqshmëria e publikut në institucionet qendrore të Kosovës ka rënë, ndërsa gatishmëria për të protestuar për arsye politike është rritur. Në raportin e UNDP-së thuhet se papunësia prin me 29 për qind, pasuar nga korrupsioni me 14 dhe varfëria me 8 për qind, si tri çështjet themelore që ndikojnë në mirëqenien e tyre sociale.





# 60 persona kanë humbur jetën në komunikacionin rrugor për gjashtë muaj

Bazuar në të dhënat e fundit për gjendjen aktuale në trafikun rrugor, vetëm në javën e kaluar kanë humbur jetën gjashtë qytetarë të Kosovës si rezultat i fatkeqësive në trafik. Sipas statistikave të Policisë së Kosovës në periudhën janar - qershor të këtij viti, 60 persona kanë humbur jetën si pasojë e aksidenteve në komunikacionin rrugor dhe 5 629 persona janë lënduar, disa prej tyre janë në gjendje të rëndë. Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka bërë thirrje për një siguri më të madhe në trafik



EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 KORRIK - Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, u ka bërë apel të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës të kenë kujdes të shtuar në trafik, veçanërisht ka kërkuar nga vozitësit për vigjilencë. Bazuar në të dhënat e fundit për gjendjen aktuale në trafikun rrugor, vetëm javën e kaluar kanë humbur jetën gjashtë qytetarë të Republikës së Kosovës si rezultat i aksidenteve në trafik.

Ai ka thënë se Ministria e Punëve të Brendshme do të jetë e pakompromis ndaj shkelësve në trafik dhe në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, me qëllim të ngritjes së sigurisë në trafikun rrugor, ngritjes së vëmendjes se do të ndërmarin veprime policore shtesë, me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë në trafik. "Të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të kontribuojnë që të kenë kujdes të

shtuar në trafik, fillimisht ta ruajnë veten dhe familjet e tyre, njëkohësisht t'i respektojnë të gjithë qytetarët që janë pjesëmarrës në trafik. Shpejtësia po vret qytetarët të Kosovës. Ju lutemi të kontribuojmë së bashku për një siguri më të madhe në trafik", ka thënë Gashi.

Ndërkaq Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se është duke përcjell në mënyrë permanente situatën e aksidenteve në trafik. Sipas statistikave të Policisë së Kosovës në periudhën janar - qershor të këtij viti 60 persona kanë humbur jetën si pasojë e aksidenteve në komunikacionin rrugor dhe 5 629 persona janë lënduar lehtë e rëndë.

Instituti Kombëtar shpreh shqetësimin lidhur me numrin e madh të aksidenteve në trafik, ku si pasojë kanë gjetur vdekjen qindra persona që paraqesin shifra alarmante dhe shumë shqetësues është fakti se shumica e viktimave

janë këmbësorë. "Shkaqet janë të ndryshme, por sigurisht se faktori njeri është më i shpeshtë pasi nuk janë duke u respektuar rregullat e përgjithshme në trafik, nga manipulimi i pasigurt me automjet, tejkalimi i shpejtësisë, mosmbajtja e distancës, mosrespektimi i shenjave të trafikut dhe mospërshtatja e kushteve të rrugës, përdorimi i shpeshtë i telefonave mobilë, vozitja nën ndikimin e alkoolit, substancave narkotike, ndikimi i lodhjes apo pagjumësisë, trajnimi joserioz gjatë

dhënies së provimit për shofer, por duke mos munguar as faktori rrugë dhe automjet ngaqë ende në shumë vende mungojnë shenjat e komunikacionit dhe veturat e vjetra me mangësi të shumta teknike, ku infrastruktura është problematike dhe drejtuesit e mjeteve janë të pakujdesshëm gjatë vozitjes", është thënë në komunikatën e IKShPK-së. Sipas IKShPK-së, qytetarët e Kosovës janë të kërcënuar nga aksidentet e trafikut rrugor, sidomos është shqetësues fakti se ndër viktimat

ka të përfshirë fëmijë. "Tek autorët e aksidenteve vërehet mungesë e edukatës qytetare për rregullat e qarkullimit të këmbësorëve dhe të automjeteve, mosdhënien e përparësive në komunikacion, mes të tjerash si persona egocentrikë, të prirë të perceptojnë se bota sillet vetëm rreth tyre, vështirë të shohin rrethin dhe t'i pranojnë të tjerët, ku veten e perceptojnë në pedestalin e kontrollit absolut ndaj të tjerëve", është thënë në komunikatën e IKShPK-së.

## Interesim i madh për t'i kontrolluar gjobat online

PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka bërë me dije se qytetarët kanë shfaqur interesim mjaft të madh për t'i kontrolluar gjobat e trafikut përmes platformës online. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka falënderuar qytetarët për mbështetjen dhe përdorimin e aplikacionit për kontrollin e gjobave si dhe përkrahjen e ofruar gjatë

këtyre ditëve. "Gjatë javës së fundit të lansimit të aplikacionit është shfaqur interesim i madh për ta vizituar faqen për kontrollim të gjobave në trafik, ku për një periudhë shumë të shkurtër statistikisht tregojnë se kërkesa ka arritur 61 000 shfletime. Ne si ministri do t'i vazhdojmë projektet e reja në të mirë dhe lehtësim të shërbimeve për qytetarët", ka shkruar ministri Gashi.



## Iu dha lamtumira e fundit pesë anëtarëve të familjes Sadikaj nga Suhareka

SUHAREKË, 10 KORRIK - Të martën janë varrosur pesë anëtarë të familjes Sadikaj nga Komuna e Suharekës të cilët kanë humbur jetën në një aksident në komunikacion. Familjarë dhe miq të shumtë kanë qenë të pranishëm në ceremoninë e varrimit të tyre që kanë vdekur të

dielën në magjistralen Suharekë - Duhël, pas përplasjes së veturës BMW me një autobus. Të aksidentuari ishin nëna, një çift bashkëshortor dhe dy fëmijët e tyre. Ngasësi, tashmë i ndjerë, bashkë me familjen kishte ardhur nga Zvicra për pushime në Kosovë.





# SBASHK-u paralajmëron grevë në shtator

EPOKA  
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 10 KORRIK - Sindikata e Bashkuar për Arsim, Kulturë dhe Shkencë (SBASHK) ka paralajmëruar për një grevë të mundshme në fillim të vitit shkollor për shkak të pakënaqësisë që e ka me Projektligjin për pagat. Përfaqësuesit e kësaj sindikate janë takuar të martën me ministrin e Arsimit, Shyqyri Bytyqi, për t'ia adresuar dy kërkesa. Njëra prej to është lidhur me Projektligjin për nivelizimin e pagave, për të cilën përfaqësuesit e SBASHK-ut thonë se i rendit mësimdhënësit në një koeficient të ulët. "Kryetari i SBASHK-ut ia ka kujtuar edhe një herë ministrit Bytyqi se nëse kjo çështje nuk

përfillet dhe nuk vepron për përmirësimin e lëshimeve në Ligjin për pagat, atëherë SBASHK-u do të veprojë duke respektuar zërin e punëtorëve të arsimit dhe se viti i ri shkollor do ta gjejë në grevë të përgjithshme tërë sistemin arsimor të Kosovës", thuhet në komunikatën e SBASHK-ut. Ata kanë ripërsëritur edhe shqetësimin e ngritur nga mësimdhënës të arsimit të mesëm të lartë lidhur me paralajmërimet nga disa DKA se do të nisë së zbatuari Udhëtimi Administrativ 6/2015 e që ka të bëjë me shpalljen e konkursit për vendet e punës për të gjithë ata që deri në përfundim të vitit shkollor 2017/2018 nuk kanë arritur të titulli master për lëndët e tyre. Kryetari i SBASHK-ut, Rahman

Jasharaj, i ka thënë ministrit Bytyqi se është e padrejtë dhe e papranueshme të vepron sipas atij Udhëzimi Administrativ për faktin se mësimdhënësve në arsimin e mesëm të lartë nuk u është krijuar mundësia t'i ndjekin programet adekuate për ta marrë titullin master. Sipas njoftimit, ministri Bytyqi është përgjigjur se nuk ka vend për shqetësim pasi MASHT-i ka formuar komisionin që do ta analizojë udhëzimin e përmendur administrativ dhe do ta zgjasë afatin duke u dhënë mundësi të punësuarve në arsimin e mesëm të lartë ta vazhdojnë ngritjen profesionale për të arritur të titulli master. Ai ka shtuar se këto afate nuk mund të shtyhen në pafundësi.



## Paqartësi rreth kostos së financimit për punëtorët e arsimit të viteve '90

EPOKA  
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 10 KORRIK - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi ka mbajtur mbledhjen e radhës të martën, të kryesuar nga Ismajl Kurteshi, kryetar, në të cilën ka shqyrtuar Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.

Anëtarët e komisionit kanë diskutuar gjatë lidhur me përmbajtjen e këtij projektligji, ndërkaq u vendos që në mbledhjen e radhës në komision të ftohen përfaqësues të ministrive përkatëse: Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës



dhe Mirëqenies Sociale për t'i marrë rekomandimet dhe sugjerimet e tyre. Kryetari i Komisionit për Arsim, Ismajl Kurteshi, ka thënë se në shqyrtim të këtij projektligji duhen ekspertë të financave dhe të dhëna nga Ministria e Arsimit

për numrin e saktë të përfutuesve. "Me një kërkesë të veçantë duhet t'i obligojmë Ministrinë e Arsimit, të Punës dhe të Mirëqenies Sociale dhe të Financave të jenë pjesë e punës sonë dhe të kemi informata të sakta për numrin e njerëzve që janë përfutues. Për tra-

jimin e këtij ligji nevojitet asistencë edhe nga ekspertët financiarë të vendit në mënyrë që të mos i sjellim vendit probleme financiare të patejkalueshme", ka thënë Kurteshi.

Deputetja e AAK-së, Teuta Haxhiu, ka thënë se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave nuk janë treguar serioze në raport me projektligjin në fjalë. "Ne kemi bërë dy debate publike dhe nuk kemi komente prej ministrive përkatëse që vazhdimisht po flasin për koston e lartë të këtij ligji. Pra, këto ministri nuk janë serioze. Duhet të kemi të dhëna të sakta sa mësimdhënës janë. Nuk mendoj se është një kosto aq e lartë sa po flitet", ka thënë Haxhiu.

Kurse deputeti i PDK-së, Nezir Çoçaj, ka thënë se sektori i arsimit më shumë se të gjithë sektorët

meriton t'u kompensohet kontributi. Ndërkaq Driton Çaushti nga Partia Socialdemokrate ka thënë se ky Projektligj duhet të shqyrtohet nga Ministria e Financave dhe ekspertët e financave dhe jo nga komisioni për Arsim. "Kemi pasur dy dëgjime publike. Përshtypja ime, prej këtyre dy dëgjimeve, është se kjo temë nuk duhet të diskutohet në komision. Kjo çështje u takon ekspertëve të financave. Për mua nuk është fare e qartë nëse ka një qartësi brenda institucioneve se ky ligj ka ndonjë ngarkesë. Nga përfaqësuesit e bankës botërore kishim vërejtje të mëdha për përgjegjësinë që marrim ne për dëmtimin e buxhetit nga ky ligj. Nuk jemi autoriteti i duhur për ta dhënë vlerësimin e një ligji që ka pasoja financiare", ka thënë Çaushti.

## Deputetët vizitojnë punëtorët grevistë në Pallatin e Drejtësisë

PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - Një delegacion i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në përbërje: Albulena Haxhiu, kryetare, Hajdar Beqa, zëvendëskryetar, Sami Kurteshi dhe Korab Sejdiu, anëtarë, kanë vizituar të martën Pallatin e Drejtësisë në Prishtinë. Qëllimi i kësaj vizite ishte njoftimi për së afërmi me kërkesat e punëtorëve të administratës së gjykatave dhe prokurorive të cilët kanë hyrë në grevë.

Këshilli grevist i ka njoftuar anëtarët e komisionit se nga data 4 korrik, kur edhe ka filluar greva, nuk kanë pasur asnjë vizitë nga



niveli qeveritar. Përfaqësues të Këshillit njoftuan anëtarët e

komisionit me kërkesat e grevistëve, të cilat kishin të bënin


me ngritjen e pagave, rregullimin e statusit të veçantë të tyre, si dhe

përvojën e punës, në mënyrë që, sipas tyre, të kthehet dinjiteti i punëtorëve në gjykata dhe prokurori.

Anëtarët e komisionit, duke i cilësuar të drejta kërkesat e punëtorëve, ofruan mbështetjen e tyre dhe kërkuan që këto kërkesa të plotësohen sa më parë. Në fund të takimit, anëtarët e Komisionit dhe Këshilli grevist u pajtuan që sot (e mërkurë) në orën 12:00 të mbahet një takim i përbashkët në ndërtesën e Kuvendit, ku i ftuar do të jetë edhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizi, kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Blerim Isufaj dhe Naim Shala, kryetar i Sindikatës së Grevistëve.



# Nuk është Hashim Thaçi as De Klerk e as Mendela që të vendosë për amnisti për krime lufte



Behxhet Sh. SHALA -  
BAJGORA

E drejta ndërkombëtare nuk amnistion kriminelët e luftës: Kohët e fundit u aktualizua bindja, në mungesë të informatave, se në një pako të një marrëveshjeje "historike" midis Kosovës dhe Serbisë apo Beogradit dhe Prishtinës, sipas ndërkombëtarëve (në këtë mënyrë e mohojnë pavarësinë e Kosovës), do të jetë edhe një amnisti për krime lufte e që nxiti shumë reagime në opinion, me të drejtë te familjet e viktimave dhe aktivistëve për të drejtat e njeriut e që pastaj disi kjo çështje u la anash sikur të mos ekzistonte fare. Sipas Kushtetutës së Kosovës, presidenti i Kosovës, që e ka emrin Hashim, ka mandat të amnistojë persona të dënuar për vepra të ndryshme penale, përjashtuar këtu ato vepra që përjashtohen me Kushtetutë siç janë: krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, gjenocidi si dhe rrezikimi i tërësisë territoriale të Kosovës dhe disa vepra të tjera. Të gjithë presidentët e Kosovës e shfrytëzuan këtë të drejtë kushtetuese për të falur të dënuar, në disa raste edhe duke e keqpërdorur këtë të drejtë, mirëpo Kosova deri më tani nuk pati amnisti sepse nuk kishte ligj për amnisti. Ishte një amnisti e përmasave më të gjëra për dorëzim të armëve që mbaheshin ilegalisht e që nuk përfundoi me një rezultat të pritshëm sikur që ishte një amnisti me të cilën faleshin strukturat kriminale në veri të Kosovës (ishte një falje e imponuar politikisht) e cila gjithashtu nuk pati përfundim të pritur, madje lirisht mund të thuhet se pati efekt të kundërt nga ajo që e planifikuan apo që e dëshiruan vendorët, të kushtëzuar nga ndërkombëtarët. Në vend se ilegalët të integrohen duke u bërë qytetarë lojalë të Kosovës, ata u integruan si qytetarë të Kosovës dhe Metohisë dhe 100 % lojalë dhe

në shërbim të Serbisë. Në vend se të zhbëhen strukturat kriminale paralele, u legalizua krimi individual, tash si krim i organizuar institucional. Sot veriu i Kosovës paraqet kubëzën më ekstreme të shovinizmit në mozaikun e Serbisë shoviniste. Madje, për nga ekstremi nacional - socialist, kriminelët e veriut ia kalojnë edhe Kishës Ortodokse të Serbisë. Ndërkaq që budallenjtë tanë "politikë" flasin për integrimin e suksesshëm të veriut. Kur flitet për të vërtetën dhe pajtimin, si shembull merret Afrika e Jugut e që nuk është shembull i mirë e lëre më të përdoret si model suksesi. Pas arritjes së Marrëveshjes për Paqe në Afrikën e Jugut që, për më shumë se 200 vjet u sundua mizorisht nga një pakicë absolute, nga Burët që kishin prejardhje nga Holanda dhe ishin të bardhë, filloi një përpjekje për ta vendosur paqen përmes ballafaqimit me të kaluarën për ta gjetur të vërtetën, të siguronte drejtësi për viktimat, të kalohej përmes reparacionit në mënyrë që të sigurohej mospërsëritja e krimeve e që për qëndrim final do ta kishte pajtimin. Shumë mirë dhe qartë e menduar dhe projektuar, por bukur vështirë e që doli të jetë edhe e pamundur për t'u realizuar. Pse ndodhi kështu, është në interes edhe për ne në Kosovë që po na imponohet një model i ngjashëm, që nga kryeadministratori Bernard Kushner, përmes Adem Demaçit e deri te balerina Frederika Moderini, përmes valltarit Hashim Thaçi. De Klerku i Afrikës së Jugut, si kryetar i të bardhëve kolonistë kishte koç... sepse kërkonte mosndjekje dhe amnisti për të gjithë kolonistët që e kishin lëkurën e bardhë pavarësisht se kishin bërë krime të tmerrshme kundër të drejtave të njeriut, kurse Mendela që i kishte koç... shumëfish më të mëdha se Uliam de Klerk kërkonte të mos bëhej asnjë kompromis, kërkonte ndjekje dhe dënim për të gjithë kolonistët burë që kishin bërë krime apo që kishin kontribuar në një mënyrë apo tjetër, por nuk e kërkonte të njëjtën gjë edhe për zezakët që kishin bërë luftë për liri, luftë të drejtë, por që edhe kishin bërë krime lufte, në emër të luftës.

Në këtë situatë pat, pa dalje, kërkohet një kompromis midis dy skajeve që e përjashtonin njëra-tjetrën, midis Mendelës dhe De Klerkut. Zgjidhja e kompromisit u gjet në personalitetin e një prifti, Desmond Tutu i cili, për angazhimin që e pati, e fitoi Çmimin Nobel për Paqe. Nuk u arrit pajtimi i dëshiruar e që nuk është arritur as sot e kësaj dite, por u pengua hakmarrja në masë e zezakëve ndaj të bardhëve. Në Kosovën e pasluftës, baca Adem Demaçi i tregoi në mënyrë të butë dhe me argumente Kushnerit se cilat kushte duhej të plotësoheshin nga Serbia për të filluar procesin e së vërtetës dhe pajtimin. Ishte kërkimfalja nga ana e Serbisë për krime në Kosovë, si akt fillestar simbolik, lirimi i pengjeve të luftës dhe të dënuarve politikë, dhënia e informatave për personat e pagjetur, kthimi i mbetjeve mortore, dorëzimi i të dyshuarve për krime lufte në Kosovë, kompensimi apo dëmshpërblimi për të gjitha shkatërrimet në Kosovë si dhe për të vrarët, kthimi i arkivave dhe kadastrës që ishte vjedhur nga Serbia, kthimi i Fondit Pensional për plaçkitur nga Serbia, kthimi i kursimeve të qytetarëve të Kosovës të depozituara në banka të ndryshme të ish-Jugosllavisë dhe mosndërrhyrja e Serbisë në punët e brendshme të Kosovës. Realisht, këto kushte ishin krejtësisht të papranueshme për Serbinë sikur edhe për bashkësinë ndërkombëtare që në Kosovë përfaqësohej nga Bernard Kushneri, imperator i Kosovës që shtrej si humanist, por që e kishte për qejf mishin e zogëzave të organizatave joqeveritare të Kosovës të cilat pastaj bënë dhe po bëjnë karrierë edhe sot në këtë fushë. Pas këtij refuzimi funksional që ia bëri Baca Kushnerit, rrugët e tyre u ndanë për t'u mos takuar kurrë për këtë çështje. Të gjithë presidentët e Kosovës e që njiheshin si presidentë të ligjshëm (pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008) flisnin për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë dhe pajtim, ndonëse Serbia, me ndihmën e ndërkombëtarëve dhe vetë këtyre presidentëve që nuk kishin fare koç..., një rast e

arsyeton anatomia për mungesë të koç..., ua fuste nga të gjitha këndet dhe në të gjitha mënyrat, ndërsa këta e merrnin si bisedime për normalizim të marrëdhënieve. Ibrahim Rugova, kur ishte president, nuk e kishte faturën presidenciale por vetëm profaturën për faktin se Kosova nuk ishte pranuar ndërkombëtarisht si shtet, prandaj edhe përgjegjësinë nuk e ka si këta të tjerët. Adem Demaçi ishte president shpirtëror i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, por se nuk e lanë kurrë të bëhej president me letra, as ndërkombëtarët e as Hashim Thaçi e as Albin Kurti. Hashimi deshi ta bëjë Begj Pacollin president dhe e bëri, ndërsa Albini e kushtëzoi votën për Bacën vetëm nëse Baca ka projekt për ta shkarkuar Hashimin e që Baca nuk e pranoi prandaj, as Baca nuk u bë president e as që Albini e rrëzoi Hashimin. Atëherë, mendoj se, përjashtuar disa raste individuale, PDK-ja nuk do ta mbështeste Bacën për president, kurse AAK-ja do ta mbështeste ndonëse nuk pajtoheshin me Bacën për disa çështje politike. Duket absurde por, në atë kohë një pjesë e LDK-së ka qenë e gatshme ta përkrahë Bacën Adem për president, në kundërshtim të Pacollit, kurse PDK-ja e ka mbështetur Pacollin për president. Përkrahja e PDK-së ka qenë vendimtare për arritjen e majave politike të Behgjet Pacollit sikur që është edhe sot për ruajtjen dhe mirëqenien politike të Behgjet Pacollit i cili, në asnjë vend tjetër, nuk do ta fitonte këtë mundësi. Jam dëshmitar okular i këtyre ngjarjeve dhe vetëm sa po e hap grykën e thesit. E them me përgjegjësinë më të madhe se PDK-ja (Thaçi dhe kompania) dhe LV-ja (Albini me disa shokë dhe shoqe) e kanë penguar zgjedhjen e Bacës Adem për president të Kosovës. Ndërkaq, një pordhë e shkrepur nga Adem Demaçi në kazamatet dhe llogoret e ish-Jugosllavisë ka kontribuar më shumë për lirinë e Kosovës se "kontributet" e presidentëve me letra përjashtuar këtu Hashim Thaçin i cili në të kaluarën e ka ujitur me djersë dhe gjak lulen e lirisë së Kosovës, kurse tani po e bënë punën m...t në të katër anët! Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimin: Kur ishte kryeministër i

Kosovës, Hashim Thaçi e formoi një grup Ndërmintor për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim që përbëhej nga pjesa pasive (përfaqësuesit e institucioneve që nuk kishin përvojën e duhur për drejtësinë tranzicionale sikur edhe nga shoqëria civile që ishte pjesë aktive për faktin se kishte njohuri të mira për drejtësinë tranzicionale). Ky grup pastaj kaloi në duar të Isa Mustafës që u bë kryeministër, por që asnjëherë nuk e pati mbështetjen institucionale. Ky grup u bë bisht i bisedimeve "teknike" - politike midis Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel. Ndërkombëtarët nuk treguan ndonjë interes për këtë grup, përveç rasteve kur ata ishin përfitues materialë sikur që ishte UNDP-ja që merrte dhe menaxhonte fonde për punën e këtij grupi dhe, madje arriti të menaxhojë fonde edhe të buxhetit të Kosovës pasi nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë duke u shndërruar në zhatës të mjeteve të buxhetit të Kosovës. Në takimin e parë të këtij grupi, pasi u themelua, pata deklaruar se ky grup do të dështojë sepse politika është përcaktuese për funksionalitetin e këtij grupi. Ashtu doli, ndonëse shoqëria civile, pjesë e këtij grupi, ishte shumë kontribuuese ani pse punoi krejtësisht në baza vullnetare. Pa shoqërinë civile ky grup do të vdiste menjëherë. Pasi Thaçi u bë president iu rritën apetitet - terapia për të kontrolluar tërë procesin e negociatave dhe doli me propozimin për ta formuar Komisionin e së Vërtetës dhe Pajtimin për çka organizoi disa konsultime me aktorë të huaj dhe të brendshëm që do të shërbente si bërthamë për komisionin e ardhshëm. Ndërkombëtarët përfaqësohen nga disa mercenarë që ngarendin pas parave në vende të krizës, ndërsa në Kosovë kryemercenari është një ish-Avokat i Popullit që nuk la asnjë gjurmë pozitive gjatë mandatit të vet si Avokat i Popullit të Kosovës, ndonëse është i huaj. Formimit të Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin i paraprinë një grup teknik për hartimin e infrastrukturës ligjore për funksionimin e këtij Komisioni.

(Vijon)



# Haradinaj në Londër: Kosova, terren i përshtatshëm për investime

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 KORRIK - Me pritjen e kryeministres së Mbretërisë së Bashkuar, Theresa May, për udhëheqësit e delegacioneve të vendeve anëtare të procesit të Berlinit dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, ka nisur të martën sesioni i parë i Samitit BE - Ballkani Perëndimor, i pesti me radhë i cili po mbahet në Londër, në kuadër të procesit të Berlinit, në të cilin Kosova po përfaqësohet nga kryeministri Ramush Haradinaj. Sesioni i parë i këtij samiti ka për diskutim temën e ekonomisë.

Në fjalën e tij, Haradinaj ka reflektuar mbi situatën aktuale ekonomike në vend, duke thënë se Kosova po ndjekë frymën e procesit të Berlinit dhe në këtë kuadër vendi ka

krijuar klimë tejet të favorshme për investimet e huaja. "Kosova tashmë e ka Ligjin për Investime Strategjike, që krijon lehtësira dhe kushte të mira për investitorët e huaj. Në këtë frymë, në këta gjashtë muajt e fundit, Kosova ka themeluar tri zona të veçanta ekonomike, që përfshijnë një territor prej 150 hektarësh të gatshme për t'i pritur investitorët e huaj", ka thënë Haradinaj.

Ai ka përmendur edhe projektet e mëdha energjetike, ato të energjisë alternative, planet për mbylljen e "Kosovës A" dhe rehabilitimin e "Kosovës B", për përfundimin e të gjitha projekteve rrugore që lidhin qytetet kryesore dhe planet për investimin e mbi 200 milionë eurove bashkëfinansim me BE-në për projektet në infrastrukturën hekurudhore. Haradinaj ka përmendur inves-



timet prej 100 milionë eurosh për projekte që trajtojnë ujërat e zeza, projektet për qytetet e gjelbra, rrugë rurale dhe projekte në infrastrukturën ujore dhe lansimin e agjendës së

digjitalizimit. "Të gjitha projektet, që lidhin Kosovën me Maqedoninë, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë, janë dëshmi e përkushtimit tonë për fqinjësi të mirë, për

bashkëpunim regional dhe e gjithë puna që po bëhet në Kosovë, është e bazuar mbi vlerat euroatlantike dhe që është rruga që Kosova po e ndjek", ka thënë Haradinaj.

## 1.2 milion euro dëmet nga të reshurat

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 KORRIK - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Nenad Rikalo, ka raportuar të martën para anëtarëve të Komisionit për Bujqësi lidhur me dëmet që të reshurat e shiut ua kanë shkaktuar kulturave bujqësore në Kosovë. Rikalo ka thënë se deri më tash janë shkaktuar dëme në vlerë 1 milion e 200 mijë euro. Ai ka shtuar se ka vështirësi në kompensimin e dëmeve pasi nuk ka një fond të veçantë në ministrinë që drejton për këto kompensime.

Rikalo ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës të ndajë mjete nga fondi rezervë i shtetit pasi ka vlerësuar se është gjendje e jashtëzakonshme sa iu përket dëmeve bujqësore. "Ajo çfarë po bëjmë tani është se menjëherë do t'i kërkojmë Qeverisë ndarjen e mjeteve nga rezervat e shtetit për ndërhyrjen



*Në bazë të vlerësimeve të para, vlera e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e fundit të shiut dhe të breshrit në Kosovë arrin shumën 1 milion e 200 mijë euro. Kjo shumë është dhënë të martën nga ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo, në raportimin e tij para Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural*

urgjente, sepse kjo është situatë e jashtëzakonshme. Bujqit duhet t'i ndihmojmë", ka thënë Rikalo.

Ai ka bërë me dije se komunat që janë prekur nga të reshurat kanë paraqitur kërkesën për t'i

ndihmuar. "Dëmet janë shumë të mëdha në Komunën e Rahovecit", ka thënë Rikalo. Ai ka theksuar nevojën e rishikimit të buxhetit për të parë se me çfarë mjete do të mund të kompensohen dëmet e shkak-

tuara. "Në vitin 2018 të gjitha komunat kanë pasur dëme materiale nga të reshurat dhe kanë paraqitur kërkesat për kompensim, ndërsa në Komunën e Rahovecit dëmet janë shumë më të mëdha", ka

deklaruar Rikalo.

Lidhur me sistemim e mbrojtjes nga breshëri, Rikalo ka thënë se ministria është duke bashkëpunuar me një organizatë zvicerane, përmes së cilës po përpiqen ta vendosin si model edhe në Kosovë.

Kurse kryetari i komisionit, Daut Haradinaj, është shprehur i shqetësuar me dëmet që janë bërë në komuna të ndryshme të Kosovës për shkak të kushteve të këqija atmosferike. Ndërkaq deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Andin Hoti, në këtë mbledhje ka kërkuar kompensimin e plotë të dëmeve në bujqësi në Komunën e Rahovecit, por edhe në komunat e tjera. Gjithashtu, ai ka kërkuar që "Programi i veçantë për fermerët e vegjël që nuk i plotësojnë kriteret e programit të përgjithshëm", i cili është në veri të vendit, të bartet në vitin 2019 në regionin e Prizrenit, duke e përfshirë edhe Rahovecin.

## Banka Botërore, projekt për punësimin e të rinjve

PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, është takuar me përfaqësuesit e Bankës Botërore (BB), të kryesuar nga Marco Mantovanelli, menaxher i kësaj banke për Kosovë, me të cilët ka diskutuar për projektin "Përfshirja e të rinjve dhe ndërmarësia". Me këtë rast Mantovanelli ka thënë se

nëpërmjet këtij projekti synohet të arrihet një përfshirje më e madhe sociale në nivelin lokal, me theks të veçantë punësimi i të rinjve të komunave të ndryshme në Kosovë. Ai ka kërkuar bashkëpunim nga ministri Reçica për jetësimin e këtij projekti, për çka mori garancën e plotë nga ministri për mbështetje dhe ndërveprim. Ndërsa ministri

Reçica e ka vlerësuar këtë projekt si shumë të rëndësishëm, marrë për bazë faktin se synon t'i përfshijë të rinjtë në punësim. Ai ka ofruar mbështetjen e plotë të MPMS-së për bashkëpunim me Bankën Botërore për projektin në fjalë. Reçica ka theksuar se të gjitha projektet që kanë për synim punësimin, sidomos të të rinjve dhe të grave, hyjnë në



kuadër të objektivave kryesore të MPMS-së dhe, si të

tilla, kanë mbështetjen e plotë të ministrisë që drejton.



# IMPAKTI GJEOPOLITIK I MARRËVESHJES GREQI - MAQEDONI



**Profesor Dr. Blerim REKA**

Marrëveshja epokale midis Greqisë dhe asaj që nga tani do të quhet Republika e Maqedonisë Veriore është shumë më tepër sesa një emër. Marrëveshja bilaterale përfundimisht hap dyert e integritetit të saj në BE dhe NATO. Por, sfidat politike mund ta vonojnë procesin, së paku dyvjeçar implementues. U deshën 27 vjet të vështira, të ndërmjetësuar nga OKB-ja, që Republika e Maqedonisë të sigurojë një marrëveshje me Greqinë me një emër të ri. Marrëveshja, e arritur nga kryeministri Zaev dhe Tsipras, më 17 qershor 2018, hap rrugën për atë që së shpejti do të jetë Republika e Maqedonisë Veriore për t'u bashkuar me Bashkimin Evropian dhe NATO-n. Dy proceset ishin bllokuar nga vetoja e Greqisë që nga viti 2006. Por, me gjithë arritjen e marrëveshjes bilaterale pritet një proces i komplikuar implementues në dy vjetet në vijim. Proceduralisht, ashtu edhe politikisht, mbeten për t'u zbatuar dy detyra të vështira. Kundërshtarët në të dy vendet (duke përfshirë edhe presidentin e Maqedonisë) tashmë po mbledhin opozitën populiste kundër marrëveshjes. Në rajon, ndërkaq, marrëdhëniet më të ngrohta midis Athinës dhe Shkupit dhe, potencialisht, midis Greqisë dhe Tiranës, nuk do të mirëpritën nga Turqia, e cila tashmë ka shtrirë me vite ndikimin në Ballkan. As Rusia nuk do të jetë e "lumtur", pasi që kundërshton anëtarësimin e Maqedonisë në NATO. Është shumë e mundshme që zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të kërkojë më shumë kohë. Megjithatë, tashmë janë ndër-marrë hapa të rëndësishëm: Kuvendi i Maqedonisë e ratifikoi marrëveshjen, fillimisht më 20 qershor, pastaj edhe më

5 korrik, pasi presidenti Gjorgje Ivanov refuzoi ta miratonte marrëveshjen, duke argumentuar se ajo "shkel Kushtetutën". Më 25 qershor Ministria e Jashtme e Greqisë njoftoi zyrtarisht me shkresë, BE-në dhe NATO-n, se heq veton mbi kërkesën e Maqedonisë për t'u bashkuar këtyre organizatave.

Jorastësisht, vetëm pesë ditë pas marrëveshjes midis Athinës dhe Shkupit, ministrat e financave të Eurozonës u pajtuan mbi një plan për ta lejuar Greqinë të dalë nga programi i saj i shpëtimit tetëvjeçar. "Krizë greke përfundon këtu sonte", tha komisionari i çështjeve ekonomike të BE-së, Pierre Moscovici. Shumë shpejt, marrëveshja për të dyja palët duket se po kthehet në një fitore të dyanshme: Win-Win.

## Sfidat procedurale

Megjithatë, mbetet një rrugë e gjatë. Këtë vjeshtë Maqedonia pritet të mbajë një referendum për ndryshimin e emrit nëse mbështetet me më shumë se gjysma e më pak se një milion votuesve të saj. Pas tij, amendamentet kushtetuese duhet të aprovohen para fundit të vitit, me një shumicë prej dy të tretash në Kuvend, ndërkohë që tash Qeveria ka vetëm 69 prej 80 votave të kërkuara. Vetëm pas tejkalimit të këtyre dy pengesave, Kuvendi i Greqisë do të ratifikojë të njëjtën marrëveshje. Maqedonia mbase do ta marrë ftesën për NATO, në Samitin e saj më 11-12 korrik, por ratifikimi i anëtarësimit të vendit mund të marrë të paktën dy vjet (si në rastin e Malit të Zi: 2015-2017). Siç deklaroi kryeministri grek Alexis Tsipras (më 29 qershor, pasi takoi sekretarin e përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg): "Së pari zbatimi i marrëveshjes, pastaj anëtarësimi në NATO". Sa për BE-në, Maqedonia (dhe Shqipëria) nuk do t'i nisin negociatat anëtarësuese këtë vit. Më 29 qershor Këshilli Evropian miratoi vendimin që data e fillimit të këtyre negociatave të shtyhet deri në qershor të vitit 2019. Pasi të fillojë "procesi i skringut" i BE-së, pranimi parashihet të

zgjaset rreth tetë vjet (deri në vitin 2027), me një vit tjetër ose dy për ratifikim. Mirëpo, vetëm nëse zgjerimi mbetet në agjendën e BE-së në dekadën e ardhshme, gjë që tash nuk është, duke marrë parasysh mosmbështetjen e kësaj politike, nga disa shtete anëtare, si Franca, Holanda dhe Danimarka.

Edhe pranimi i Maqedonisë në OKB do të jetë i ndërlikuar pasi ndryshimi i emrit do të kërkojë veprime të mëtejshme nga shtetet anëtare që tashmë e kishin njohur vendin nën emrin e tanishëm kushtetues - Republika e Maqedonisë. Derisa rruga teknike (procedurale) është relativisht mirë e precizuar, aspektet politike janë shumë më pak të parashikueshme; si në vend ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar. Si do të reagojnë kundërshtarët e marrëveshjes në Maqedoni dhe Greqi dhe çfarë do të bëjnë fuqitë rajonale dhe ato të mëdha?

## Politika e brendshme

Në Maqedoni duket se të paktën dy parti politike do të vazhdojnë ta kundërshtojnë "marrëveshjen e emrit të ri". Njëra është VMRO-DPMNE (partia kryesore e opozitës, e cila e quajti marrëveshjen "kapitullim" dhe "tradhti kombëtare"). Partia tjetër është e vogël (Maqedonia e Bashkuar, e cila ka organizuar demonstrata kundër marrëveshjes me flamuj maqedonas dhe rusë dhe udhëheqësi i saj Janko Bachev nuk e ka fshehur që partia është me Kremlinin). Së fundja, presidenti Gjorgje Ivanov ka refuzuar dy herë ta nënshkruajë marrëveshjen, duke thënë se është "jokushtetuese". Ky veprim mund të sjellë krizë kushtetuese, pasi që presidenti nuk mund ta refuzojë nënshkrimin e ligjit që është miratuar nga parlamenti për herë të dytë. Bojkoti i tij, i kombinuar me demonstrata të rregullta rrugore të organizuara nga partitë e opozitës, do ta mbajë atmosferën politike të tensionuar dhe të paqëndrueshme, sa më shumë afrohet referendumi i vjeshtës.

Dy fuqitë e jashtme nuk e fshehën pakënaqësinë e tyre. Zyrtarët rusë thanë se nuk kishin "asgjë kundër marrëveshjes", por u kujdesën për t'i nënvizuar shqetësimet e tyre se do ta lejonte Maqedoninë t'i bashkohej NATO-s. Serbia ishte më eksplicite, duke mos uruar Qeverinë maqedonase për përpërimin diplomatik. "Nuk kemi asgjë për të uruar", tha ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić. Greqia ka po aq kundërshtarë të brendshëm. Partia kryesore e opozitës, Demokracia e Re, ka kritikuar marrëveshjen, ndërsa partnerja e koalicionit të kryeministrit Alexis Tsipras, Grekët e Pavarur (ANEL), thotë se do të kundërshtojë marrëveshjen nëse nuk miratohet nëpërmjet një referendumi kombëtar apo zgjedhjeve të reja. Mosmarrëveshja për këtë çështje brenda Qeverisë është e rëndësishme, pasi Tsiprasi duhej t'i mbijetonte mocionit të mosbesimit në Kuvend vetëm një ditë përpara nënshkrimit të "marrëveshjes së emrit të ri". Gjykata Kushtetuese greke gjithashtu ka pranuar kërkesën për anulimin e marrëveshjes. Megjithatë, kryeministri grek së paku gëzon një avantazh ndaj homologut maqedonas: Presidenti grek Prokopis Pavlopoulos ka deklaruar mbështetjen e tij.

## Rivalitetet rajonale

Ndikimi rajonal i marrëveshjes bilaterale është një tjetër rrëfim. Greqia mund të ketë zgjidhur një çështje me Maqedoninë, por mbetet me çështje të hapura me dy fqinjët e tjerë: Shqipërinë dhe Turqinë. Të dyja kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet territoriale, veçanërisht mbi të drejtat e rezervave të naftës dhe të gazit në det të hapur. Në rastin e Shqipërisë çështja kryesore e mosmarrëveshjes është shiriti detar prej 140 kilometrash i detit Jon me Turqinë, ndërkaq janë Ishujt Egje dhe Qiproja e Veriut. Grupet punuese diplomatike shqiptare dhe greke duket se janë afër përfundimit të një marrëveshjeje për Detin Jon, por opozita shqiptare kritikon për "falje" të territorit të kontestuar. Fillimisht, të dyja

palët kishin shpresuar të nënshkruanin një marrëveshje përfundimtare para takimit të Këshillit Evropian në Bruksel më 28-29 qershor, e cila ishte anuluar në çastet e fundit. Pritet që dy kryeministrat ta diskutojnë përparimin në marginat e Samitit të Ballkanit Perëndimor në Londër që filloi më 10 korrik 2018.

Një afrim i mundshëm në mes të Athinës, Shkupit dhe Tiranës do të përcillet me shumë kujdes nga Ankaraja. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit Turqia ishte fuqia kryesore rajonale në Ballkan - si ekonomikisht, (nëpërmjet tregtisë së konsiderueshme dhe investimeve), ashtu edhe në aspektin kulturor, (përmes programeve për ta promovuar gjuhën dhe kulturën turke nëpërmjet shkollave turke lokale). Në pesë muajt e parë të vitit 2018 eksportet e Turqisë në Ballkan u rritën 22 për qind, ndërsa Agjencia Turke për Çështje Kulturore rriti donacionet e saj për kulturën dhe arsimin në rajon. Zyrtarët e lartë turq kanë lidhje të ngushta personale me homologët e tyre në Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi. Ndjenja pro-turke është gjithashtu e dukshme në disa pjesë të popullsisë, siç u pa nga festimet e rrugëve në disa qytete të Ballkanit Perëndimor pas fitores së presidentit Rexhep Tajip Erdogan në zgjedhjet presidenciale të 25 qershorit në Turqi. Rirregullimi i marrëdhënieve të Greqisë me fqinjët e saj do të zhvendoste busullën gjeopolitike midis Athinës dhe Ankarasë. Turqia tashmë ka bërë një investim të madh financiar dhe kulturor në rajon. Greqia, ndërkaq, duke zhbllokuar procesin e integritetit euroatlantik për fqinjët veriorë, mund të bëhet një lojtare më e madhe Euro-Atlantik dhe ta riformësojë bilancin rajonal.

## Fuqitë e mëdha

Elementi i tretë në këtë trekëndësh rajonal është përfshirja e Fuqive të Mëdha. Rusia ka kundërshtuar fuqishëm anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, duke ushtruar ndikim nëpërmjet



aleates më të madh rajonale - Serbisë. Megjithatë, marrëdhëniet më të ngrohta midis Moskës dhe Ankarasë do të tentojnë të punojnë kundër ndikimit të Greqisë në Ballkanin Perëndimor - veçanërisht tani që Athina po rishfaqet si një lojtare konstruktive.

Kjo mund të shihet edhe nga toni më i lehtë në marrëdhëniet e ShBA - Greqi. Në dëgjimin e parë të Senatit Amerikan, ndihmës-sekretari amerikan i Shtetit, Wes Mitchell, tha: "Ne po e mbajmë Greqinë si një spirancë të stabilitetit në Mesdhe dhe në Ballkanin Perëndimor". Uashingtoni ishte një nga të parët që përgëzoi Maqedoninë dhe Greqinë për marrëveshjen bilaterale dhe zëvendës-presidenti i ShBA-së, Pence, përgëzoi dy kryeministrat, Zaevin dhe Tsiprasin, vetëm pesë ditë përpara Samitit të NATO-s. Këto sinjale duket se do t'i lëkundin kambanat diplomatike të Ankarasë.

Po aq duhet të shqetësohet edhe Moska. Pasi të zgjidhen mosmarrëveshjet Greqi - Maqedoni dhe Greqi - Shqipëri, hapet rruga për strategjinë euroatlantike në Ballkan. Me Greqinë, Turqinë dhe Shqipërinë tashmë anëtare të NATO-s dhe Maqedoninë që do të bashkohet, siç e bëri vjet Mali i Zi, matematika rajonale do të ndryshojë vendosmërisht kundër Kremlinit.

Kjo është arsyeja pse disa anëtarë të BE-së kritikuan vendimin për t'i vonuar bisedimet e pranimin me Shqipërinë dhe Maqedoninë, duke argumentuar se kjo do të ndihmojë vetëm në nxitjen e ndikimit rus. Është e qartë se politika e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor ka një ndikim të rëndësishëm geopolitik. Largimi i rajonit nga sfera euroatlantike do të paraqiste një rrezik të madh geopolitik.

**Skenarët: Rivalitet ose ndarje**

Skenari më i mundshëm është se Greqia do të ketë sukses në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të saj bilaterale me fqinjët veriorë. Kjo do ta mbyllte unazën jugore të NATO-s, por do t'i sfiidojë marrëdhëniet me Turqinë. Deri tani Ankaraja ka ushtruar ndikim vendimtar në Maqedoni dhe Shqipëri. Po aq po rritet ndikimi i Turqisë në Serbi, ku Qeveria e Beogradit po tërheq investimet turke. Edhe Moska dhe Ankaraja do ta preferonin Beogradin si lider rajonal, duke kundërshtuar përpjekjet e ShBA-së për ta mbështetur Athinën.

Duke qenë anëtare e NATO-s, vështirë që Turqia do të mund të punojë shumë ngushtë me

Moskën. Si rezultat, nuk do të ketë opozitë turke ndaj aspiratave të Maqedonisë për në NATO. Por, në vend të kësaj, Ankaraja do t'i përqendrojë përpjekjet e saj në bllokimin e Athinës nga të qenit një lojtare rajonale.

Skenari i dytë, më pak i mundshëm, është që Turqia dhe Greqia të pajtohen mbi sferat e tyre të ndikimit në Ballkanin Perëndimor. Dy parametrat kryesorë për çdo ndarje të tillë do të ishin energjia dhe kultura.

Sa i përket energjisë, ndarja do të bëhej në bazë të projekteve kundërshtuese gazsjellëse: "Rrjedha Turke" e Rusisë dhe Gazsjellësi "Trans Adriatik Pipeline" (TAP) i BE-së, pjesë e Korridorit Jugor më të madh të gazit. Për Ankaranë dhe Moskën, një nga çelësat e projektit të Rrjedhës Turke është bashkëpunimi me Maqedoninë dhe Serbinë, që gazi ta arrijë tregun e BE-së nëpërmjet Hungarisë. Sa i përket TAP-it, Greqia duhet të punojë me Shqipërinë (por edhe Kosovën dhe Malin e Zi) për t'i siguruar dërgesat në Itali, drejt BE.

Në aspektin kulturor, Ballkani Perëndimor po ashtu mund të ndahet midis Turqisë dhe Greqisë përgjatë vijave fetare. Nëse kjo do të ndodhte, do të krijonte ndarje sektare përgjatë vijave në Evropë, sipas modelit të Lindjes së Mesme. "Ballkani Ortodoks", (Serbia dhe pjesët e Maqedonisë), do të dominohej nga Rusia. Vendet me shumicë myslimane (Shqipëria, Kosova dhe një pjesë e Maqedonisë) do të dominoheshin nga Turqia.

Mirëpo, ky skenar, në praktikë, është më pak i besueshëm për shkak të hartës së ndërlikuar fetare, e cila përshkon pothuajse të gjithë kufijtë shtetërorë. Serbia është kryesisht ortodokse dhe me ndikim të fortë rus, por përmban të paktën dy territore kompakte me shumicë popullsi myslimane - Sanxhaku (shumica boshnjake etnike) dhe Lugina e Preshevës (shumicë etnike shqiptare). Bosnjë dhe Hercegovina është edhe më keq, pasi është e ndarë përgjatë vijave fetare dhe politike. Republika Srpska, me shumicën serbe, mban lidhje të ngushta me Beogradin dhe Moskën, ndërsa Federata (e ndarë midis boshnjakëve dhe kroatëve) kërkon udhëzime nga Turqia dhe BE-ja.

Ndarja fetare duket e pamundur, vetëm në Shqipëri dhe Kosovë, shtetet më pro-amerikane në Ballkan, sepse shqiptarët edhe pse kanë tre religjione, kurrë nuk kanë pasur asnjë luftë fetare gjatë historisë.

**(Botuar në Geopolitical Intelligence Service. Përktheu dhe përshtati nga anglishtja: Arsim Osmani)**



**Ministria e Infrastrukturës investon në dy projekte infrastrukturore në Mitrovicën e Veriut**

MITROVICË, 10 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, dhe kryetari i Mitrovicës së Veriut, Goran Rakiq, kanë nënshkruar të martën marrëveshje bashkëpunimi për dy projekte infrastrukturore të kësaj komune, të cilat kapin vlerën totale prej 90 mijë

eurosh. Marrëveshja e bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Mitrovicës së Veriut u nënshkrua për asfaltimin e rrugës "Sami Frashëri" dhe ka vlerën 40 mijë euro, si dhe për asfaltimin e rrugës "Tirana" e që ka vlerën prej 50

mijë eurosh. Ministri Lekaj dhe kryetari Rakiq, biseduan edhe për çështje të tjera, kurse nga ministri Lekaj u ritheksua mbështetja dhe përkushtimi i Qeverisë së Kosovës për t'i përkrahur të gjitha komunat e vendit pa dallime etnike.



**Universiteti i Gjakovës i bashkohet VALA-s**

GJAKOVË, 10 KORRIK (ER) - Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" ka vendosur t'i bashkohet operatorit publik VALA, duke nënshkruar një marrëveshje e cila përfshin marrjen e shërbimeve të VALA-s nga ana e stafit menaxhues,

profesorëve dhe tërë personelit tjetër administrativ. Të gjithë zyrtarët e këtij universiteti tash e tutje do të jenë në rrjetin e VALA-s duke përdorur numrat "PostPaid", ndërsa tri objekteve universitare të këtij qyteti Telekomit i Kosovës do t'u

mundësojë telefoni fikse, kabull optik për shërbime studentore si dhe internet të shpejtë. Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Gent Begolli, ka thënë se shërbimet e VALA-s janë duke u mirëpritur nga konsumatorët.



# PROBLEME THEMELORE TË PUNIMEVE STUDIMORE (6)



Hajdin ABAZI

## 7. Pak originalitet në hyrje dhe në rekomandime

Deskriptivizmi ka diktuar, me sa duket, edhe formulimet në mënyrë pavetore, për çfarë vetëm pak originalitet mund të haset në pjesën e hyrjes dhe te rekomandimet.

Në pjesën e "hyrjes", kryesisht për shkak të zbatimit të rregullores së studimeve, ndihet prania e autorit/autorëve kur shtron qëllimin e studimit, objektivat, pyetjet studimore dhe hipotezat. Dhe, ashtu sikundër u tha më sipër, zakonisht kjo është pjesa më e zbehtë, më anemike e një studimi të tillë, sikurse janë praktikata e deritashme në shumicën e punimeve studimore. Edhe në "hyrje" ndihet mekaniciteti i veprimit, shprehjet e shtrënguara dhe të formuluarat si me zor. Kjo mund të kuptohet edhe nga fakti se në shumicën e rasteve harrohen ato përgjatë tërë studimit dhe sidomos aty, në "përfundim", ku do të duhej të tregohet se çfarë është bërë me to si rezultat i studimit. (Kjo çështje do të shqyrtohet më poshtë).

Një pjesë tjetër ku, befas, shfaqet autori është pjesa krejt e fundit, në përmbyllje të studimit. Ajo pjesë që zakonisht quhet "rekomandime". Duket se i tërë përshkrimi përgjatë studimit kishte një funksion të vetëm kryesor - të krijonte nevojën për rekomandime. Sigurisht, nuk ka asgjë të keqe me rekomandimet, kur ato janë me vend dhe të natyrës së studimit. Për këtë do të flitet më pas, por këtu dua të nënvizoj se duket sikur i tërë përshkrimi deskriptiv është një trase që të arrijë në një përfundim të panatyrshëm, sepse në shumicën e rasteve rekomandimet nuk kanë ndonjë

referencë në punim, kurse ndonjëherë dhe shumë rrallë rekomandimet kanë referencë në punim. Por në shumicën e rasteve rekomandimet nuk rrjedhim logjikisht nga ajo që është thënë gjatë studimit.

## 8. Deskriptiviteti si anemi shkencore

Deskriptivizmi zakonisht është jo i duhur për punime të natyrës universitare, në kuptimin se nuk mund të jetë qasja themelore, sidomos nuk do të duhej të ishte, sikurse u tha, kur është fjala për tema të njohura e të rrahura shpesh. Nëse ka diçka këtu gabim, ai është te përdorimi i deskriptivizmit si mënyrë kryesore e studimit, kur ajo, në të vërtetë, do të duhej të ishte vetëm si teknikë ndihmëse.

Punime të shumta, për shkak të natyrës kryekrejt deskriptive, më shumë ju ngjajnë ciceronëve (guidave), ku, fjala vjen, përshkruhet një institucion përkatës, hierarkia e tij, funksionimi, ligjet që e rregullojnë, fushat që i mbulon, detyrat dhe përgjegjësitë, kush i krijon ato, kush i kontrollon dhe si bëhet emërimi/zgjedhja e liderit. E njëjta gjë ndodhë edhe kur ndonjë punim merr për shtjellim tema lidhur me ndonjë dukuri negative, ndonjë sjellje, botëkuptim, pikëpamje, perceptim etj. Ndaj punimet e tilla janë dhe vuajnë nga anemia shkencore.

Çka mësohet prej punimeve të tilla të karakterizuara nga deskriptivizmi? Pak gjë, për mos të thënë hiçgjë, që tashmë nuk është e njohur.

## 9. Sasia në dëm të cilësisë

Përse shumica e autorëve të punimeve preferojnë deskriptivizmin?

Arsyeja kryesore është te lehtësia e deskriptivizmit si qasje. Për shkak se ai është më pak kërkuar ndaj studiuesit. Burimet janë të mjaftueshme që mund të mbushen faqet me përshkrime, duke krijuar kështu perceptimin e bërjes së një punimi studimor, por pa e bërë atë në të vërtetë.

Ajo që përmban pjesa e studimit, domethënë ajo që pason pas "hyrjes", në të gjithë kapitujt deri te "përfundimi", zakonisht është transmetim i asaj çfarë kanë thënë të tjerët, ose ashtu sikurse janë të përshkruara qartë në akte që i përshkruajnë, shpjegojnë e rregullojnë ato.

Qasja deskriptive, në këso rastesh, krijon hapësirë për sasi, por në kurriz të cilësisë, duke nënkuptuar me këtë mendimin autorial, mungesën e perspektivës së studiuesit, të këndvështrimit alternativ, kritik dhe zhbirues. Në studime të tilla zakonisht autori nuk shfaq gjëkund mendimin e vet se çka mendon, si e sheh gjendjen në kohën e studimit, a ka të meta e mangësi dhe nëse po - ku, si i vlerëson ato, si e sheh gjendjen, a ka ndonjë pikëpamje të veten dhe konkretisht a sheh ndonjë gjë që do të duhej të theksohej.

Pikërisht këtu qëndron mangësia e qasjes deskriptive, se ajo ka për mision të përshkruajë, të tregojë se si është gjendja, struktura, mënyra e funksionit, rezja e veprimit, aspekti i rregullimit normativ-juridik etj.

Ndonëse mund të jetë përmbushur standardi i sasisë, që kërkohet nga rregulloret universitare, mund të jenë përshkruar në mënyrë të duhur institucionet në fjalë, prapë se prapë zakonisht prej tyre ose nuk sillet ndonjë kontribut fare ose ai është tepër i varfër.

## 10. Përfundimet/rekomandimet zakonisht nuk janë rrjedhë e punimeve

E vetmja mundësi për të treguar diçka më ndryshe, për të dalë nga korniza e deskriptivizmit, janë rekomandimet.

Ndaj nuk është aspak çudi pse këto përfundime zakonisht nuk janë derivat i asaj çfarë është shtjelluar në punimin, por çfarë ka ndërmend autori përgjatë studimit. E pra, përfundimet duhet të rrjedhin nga ajo që është shkruar përgjatë studimit e jo nga që mund ta ketë ndërmend ai/ajo.

Përndryshe, ato janë si të ndërftuara me pahir e pa ndonjë funksion.

## 11. Duhet të ndryshohet qasja deskriptive e punimeve studimore

Shikuar nga aspekti formal, me hyrje e kapitujt e përfundime e rekomandime, punimet lënë përshypjen e një realizmi metodologjik të standardeve bashkëkohore. Kjo, për fat të keq, në shumicën e rasteve, është vetëm dukje.

Po qe se shihet nga aspekti përmbajtësor atëherë qartë shpërfaqet niveli i bërjes punime studimore, një nivel që zor se mund të quhet shkencor. (Këtë nuk e zbusin as rekomandimet, për shkak se ato zakonisht nuk janë rrjedhim nga ajo që shtjellohet në punime). Kjo qasje, me dominimin e deskriptivizmit, duhet të ndryshohet. Duhet të vetëdijeshohen kandidatët se, ndonëse mund të marrin titull shkencor, nuk bëhen dot shkencëtarë përmes shkruarjes së punimeve në mënyrë deskriptive. Ato, as që kanë ndonjë dobishmëri reale, qoftë edhe minimale, ndaj dhe mbeten një ngarkesë për arkivin (klasik ose digital) të universiteteve.

## 12. Bashkëpërgjegjësia e mentorit

Deri këtu nuk fola ndonjë gjë për bartësit kryesor të kësaj fryme. Ata janë, zakonisht, mentorët, si drejtues shkencor. Sigurisht, mund të kuptohen prirja e kandidatëve për qasjen deskriptive për shkak të lehtësisë së realizimit të punimit. Për këtë, gjithsesi, nuk janë vetëm ata përgjegjës. Po aq janë edhe mentorët. Këta kanë për detyrë të kontribuojnë që studimi të mos mbetet i kufizuar në përshkrime. Nuk duhet kënaqur me kërkesën minimaliste, vetëm që të realizohet studimi, të mbushet kuota e faqeve dhe të përplotësohet standardi. Mentorët, në cilësinë e drejtuesit shkencor, duhet të nxisin kandidatët të kapërcejnë deskriptivizmin, të shkojnë përtej saj, të dalin në fushën e mirëfilltë të studimit. Që të bëhet kjo, ndër të tjera, kërkohet që mentori t'u

kushtojë kohë e vëmendje secilit kandidat dhe të jetë i qasshëm për secilin përtej parametrave zyrtar; aq më tepër kur kjo tashmë përmes komunikimit elektronik është bërë e mundshme pa ndonjë kosto, qoftë me e-mail e qoftë me komunikim përmes bisedave me programe falas në telefonat inteligjentë. Përndryshe, për punimet që vuajnë nga deskriptivizmi bashkëpërgjegjës janë edhe mentorët.

## 13. Të braktiset formaliteti dhe të krijohet klima studimore

Deskriptivizmi si qasje studimore kështu shpërfaq një shqetësim më të thellë dhe më brengosës në aspektin përmbajtësor sesa në aspektin formal. Ai ka një relacion të trefishtë: universitete-mentorë-kandidatë. Ajo çka një kandidat realizon përmes një punimi nuk duhet parë vetëm si nivel i tij/saj, por edhe si nivel i mentorit dhe, po ashtu, edhe si nivel i universitetit. Po bien kabanat alarmuese për të gjitha universitetet, kudo në trevat shqiptare, që punimet prej të cilave merren tituj duhet të marrin një kah tjetër, të ngritën në një nivel më të lartë dhe të marrin karakterin e mirëfilltë studimor. A është kjo e mundur? Unë besoj dhe jam i bindur se po. Por për ta ndryshuar këtë, për ta ngritur cilësisht studimin, duhet që universitetet kudo në trevat shqiptare të marrin qëndrim për të shtuar kërkesat, duhet që mentorët të tregojnë përkushtim ndaj atyre që janë duke bërë studimin e tyre të parë shkencor, të udhëhiqen mirëfilli në realizimin e studimit.

Me fjalë të tjera, duhet të krijohet një klimë e mirëfilltë studimore, duke i ndërgjegjësuar kandidatët dhe duke i inkurajuar që të bëjnë punë serioze dhe të zbatojnë një metodologji të ndërthurur, ku pjesa më pak e rëndësishme, zakonisht, do të mbetet deskriptivizmi. (Vijon)

(Autori është prof. ass. dr. dhe ka ligjruar për shumë vjet lëndët Shkrimi akademik dhe Metodologjia e hulumtimit shkencor)

## Gjini kërkon të luftohet përdorimi i substancave narkotike në Gjakovë

GJAKOVË, 10 KORRIK (ER) - Komisionit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) në Komunën e Gjakovës ka mbajtur mbledhjen e rashës, në të cilën komandanti i Stacionit Policor në Gjakovë, major Kristë Gjokaj, ka raportuar për gjendjen e sigurisë për gjashtëmuorin e parë të vitit 2018. Sipas këtij raporti, gjendja e sigurisë në periudhën në fjalë është mjaft e mirë në të gjitha aspektet, madje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka zvogëlim të

rasteve në masë prej 17 përqindësh. Një raport për përmbylljen e gjysmëvjetorit të parë e ka dhënë drejtori i Drejtorisë për Arsim, Bernard Frokaj, i cili ka thënë se ky gjysmëvjetor është mbyllur në mënyrë të rregullt dhe pa probleme të theksuara. Drejtori Frokaj e ka vlerësuar si të lartë edhe nivelin e sigurisë nëpër shkollat e Komunës së Gjakovës. Në përmbyllje të këtij takimi, kryetari i komunës, Ardian Gjini, ka thënë se të gjithë aktorët e

përfshirë në sigurinë publike duhet të jenë edhe më të fokusuar dhe përmes analizave dhe veprimeve konkrete ta bëjnë vlerësimin dhe monitorimin e situatave, ndërhyrjen në rastet kur kërkohet, por edhe krahasimin e periudhave dhe lëvizjeve të statistikave në periudha të ndryshme.

Kryetari Gjini ka kërkuar që fokus më të madh të ketë në luftën kundër përdorimit të substancave narkotike dhe sigurinë në shkolla.





## Stoltenberg: Së shpejtë ftesa për Maqedoninë

**BRUKSEL, 10 KORRIK** - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg tha se pret që aleanca të bjerë dakord të ftojë Maqedoninë për të filluar bisedimet e pranimit në Aleancë. "Sapo të finalizohet dhe të zbatohet marrëveshja mbi çështjen e emrit, ne do të mund të ftojmë ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë të bëhet anëtarja e 30-të e NATO-s nën emrin e saj të ri: Republika e Maqedonisë Veriore", tha Stoltenbergu në një

konferencë me gazetarë të martën në selinë e NATO-s në Bruksel.

Ai tha se kjo do të përbente "një sinjal të fortë" që dera e NATO-s është dhe do të vazhdojë të jetë e hapur.

Maqedonia zgjidhi një mosmarrëveshje 10-vjeçare me Greqinë, anëtare e BE-së dhe e NATO-s, duke rënë dakord të quhet Maqedonia e Veriut.

Ndërsa morri pjesë në samitin e vendeve të Ballkanit Perëndimor

në Londër, ministri i Jashtëm i Maqedonisë Nikolla Dimitrov i tha agjencisë së lajmeve Reuters se vendi i tij "kashpresa të mëdha dhe se mendon se gjithçka do të ndodhë këtë javë". Ai tha gjithashtu se vendi i tij "duhet të jetë gati për t'i filluar bisedimet e pranimit".

Në këmbim të ndryshimit të emrit, Athina do të tërhiqet nga kundërshtitë e saj ndaj Shkupit për anëtarësimin e vendit në NATO dhe në Bashkimin Evropian.



# Samiti i Londrës rikthen investimet për siguri dhe stabilitet në Ballkan

Kryeministria britanike Theresa May në Samitin e Londrës ka publikuar pakon e masave për ndihmë për Ballkanin Perëndimor, për të ndihmuar përparimin e sigurisë kolektive dhe stabilitetit ekonomik të rajonit.

Kryeministria May ka theksuar se Samiti i Londrës edhe një confirmim më shumë i Qeverisë britanike për perspektivën evropiane të vendeve të rajonit



**LONDËR, 10 KORRI** - Samiti i Ballkanit Perëndimor, i cili po mbahet në Londër, ka mbledhur liderët e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, partnerë të Bashkimit Evropian dhe përfaqësuesit e institucioneve evropiane, që të punojnë së bashku për t'i dhënë mbështetje sigurisë, stabilitetit dhe përparimit të rajonit.

Kryeministria britanike, Theresa May është mikpritëse e këtij takimi, i cili paraqet Samitin e pestë me radhë që mbahet me vendet e Ballkanit Perëndimor. Shefat e delegacioneve të vendeve anëtare të Procesit të Berlinit dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilët janë të pranishëm në samit, si dhe përfaqësuesit e Komisionit Evropian, janë pritur të martën nga kryeministria britanike, Theresa May.

Kjo e fundit, ka kryesuar sesionin plenar të samitit, në të cilin ishte paralajmëruar se do të bëhet prezantimi i planeve për Samitin në Varshavë, në vitin 2019.

Kryeministria britanike May, ka publikuar pakon e masave për ndihmë për Ballkanin Perëndimor, për të ndihmuar përparimin e sigurisë kolektive dhe stabilitetit ekonomik të

rajonit.

Në faqen zyrtare të Samitit të Londrës, është thënë se pakoja e masave do ta ndihmojë rajonin që t'i zgjidhë sfidat komplekse të sigurisë.

Kryeministria May ka theksuar se Samiti i Londrës edhe një confirmim më shumë i Qeverisë britanike për perspektivën evropiane të vendeve të rajonit.

"Historia ka dëshmuar se stabiliteti dhe siguria e rajonit të Ballkanit Perëndimor nënkupton një Evropë më stabile dhe më të sigurt. Ne po e braktisim Bashkimin Evropian në marsin e ardhshëm, por edhe më tej jemi të përkushtuar për përparimin e prosperitetit dhe sigurisë të Ballkanit Perëndimor, tash, por edhe në vitet që do të vijnë", ka thënë May.

Duke folur për pakon e masave, kryeministria britanike May, ka vlerësuar se këto masa do ta ndihmojnë edhe vendin e saj.

"Pakoja që e kam publikuar sot do ta ndihmojë Ballkanin Perëndimor që të ballafaqohet me kërcënimet ndaj përparimeve të tyre, sikurse krimit serioz dhe të organizuar, tregtisë me drogë dhe terrorizmit. Por, në të njëjtën kohë do të ketë efekt edhe në Britaninë e Madhe, duke i zvogëluar

aktivitetet kriminale në vetë burimin e tyre dhe me këtë do të pengojë që kriminaliteti të arrijë deri te rrugët britanike", theksoi May.

Pakoja e masave përfshin rritjen për 95 për qind të financimit britanik në rajon dhe nga 41 milionë funte, sa ishin mjete financiare nga Fondi për parandalimin e konflikteve, për siguri dhe stabilitet në vitin 2018/2019, është ngritur shuma në 80 milionë funte për vitin 2020/2021.

Gjithashtu, do të dyfishohet numri i britanikëve, të cilët do të punojnë në rajon, në çështjet e sigurisë që ndikojnë në Britaninë e Madhe dhe në Ballkan.

Në Samitin e Londrës është duke marrë pjesë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, së bashku me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, si dhe ministrin e Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi.

Një sesion tjetër i samitit do të kryesohet nga kancelarja gjermane Angela Merkel.

Gjithashtu, në sesionin plenar, lidhur me temën "E ardhmja e Procesit të Berlinit" është paralajmëruar se do të flasin kryeministri polak Mateusz Morawiecki, kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel dhe komisionari për Zgjerim, Johannes Hahn.

Me fjalimin e komisionarit Hahn, kanë nisur punimet e së martës të Samitit të Londrës. Ai ka folur për procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Hahn ka thënë se vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor duhet të bëjnë ndryshime për të përparuar në rrugën e tyre drejt BE-së. Ai, gjithashtu, ka vlerësuar se në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë shënuar përparime, ndërkohë që ka shprehur mbështetjen për hapjen e negociatave të Bashkimit Evropian me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Lidhur me këto dy të fundit, ai ka theksuar se gjatë

vitet të ardhshëm do të vlerësohet ecuria e të dy vendeve.

Samiti fokusohet në tri çështje kryesore: Rritjen e stabilitetit ekonomik, trajtimin e papunësisë për të rinjtë dhe ndërlidhjen rajonale; Forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe të sigurisë për t'i paraprirë kërcënimeve të përbashkëta përfshirë, korrupsionin, krimin e organizuar, trafikimin e njerëzve, drogës dhe armëve të zjarrit, terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm; si dhe lehtësimin e bashkëpunimit politik për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe tejkalimin e problemeve të akumulua nga konfliktet e viteve 1990.

Samiti në Londër është pjesë e Procesit të Berlinit dedikuar Ballkanit Perëndimor iniciuar nga kancelarja gjermane Angela Merkel në vitin 2014, i cili ishte pasuar përgjatë viteve me samite tjera, gjatë të cilave ishin nënshkruar marrëveshje të shumta në fusha të caktuara.

## Erdogani prezanton kabinetin, ministër edhe dhëndri me emër shqiptar

**ANKARA, 10 KORRIK** - Disa ditë pasi fitoi në zgjedhjet presidenciale të Turqisë, Rexhep Taip Erdogan u betua në Parlament për mandatin e dytë si president, por këtë herë me fuqi të shumta ekzekutive.

Të martën Erdogan ka prezantuar edhe kabinetin e tij qeveritar, të përbërë nga 16 ministra, ndërsa emri i njërit prej tyre, është ai që ka bërë më shumë "zhurmë".



Bëhet fjalë për Berat Albayrak, i cili është dhëndri i presidentit Erdogan dhe është emëruar nga

ky i fundit si Ministër i Thesarit dhe Financave.

Ky vendim është interpretuar nga kritikët, si një tentativë e presidentit për të pasur kontroll të plotë në jetën ekonomike dhe financiare të vendit.

Berat Albayrak është 40 vjeç dhe

prej vitit 2004 është i martuar me vajzën e presidentit, Esra Erdogan. Më herët ai ka qenë edhe drejtor ekzekutiv i Çal?k Holding, ndërsa ka mbajtur edhe postin e ministrit të Energjisë dhe Burimeve Natyrore.



E rrallë

# Një pasagjer nuk e ka problem të rrijë i varur jashtë dyerve të trenit

Një person qëndron tek dyert e jashtme të trenit në Nju Jork teksa ky i fundit është në lëvizje. Ky person arrin të mbahet i kapur dhe nuk pëson asnjë dëmtim derisa treni arrin në stacion.



FOTO E DITES



Zjarrfikësit e Indonezisë përpiqen të shuajnë një zjarr në anijet e peshkimit në portin Benoa në ishullin turistik të Indonezisë. /AFP/

E jashtëzakonshme

# Dinozaurët jetonin miliona vjet më herët se ç'mendohej

Një ekip ekspertësh në Argjentinë ka konstatuar se dinozaurët gjigantë kanë jetuar në tokë rreth 25 milionë vjet më parë sesa që është menduar fillimisht. Përfundimet e publikuara në revistën "Nature Ecology & Evolution" thonë se ekskavatorët zbuluan



eshtrat e specieve 200 milionë vjeçare, me emrin Ingenia prima. Këto specie kanë qenë rreth trefishi i madhësisë së dinozaurëve më të mëdhenj të epokës, Triasik.

## BARSOLETA E DITËS



Një i burgosur e pyet tjetrin:

- Për çfarë të kanë sjellë këtu?

- S'po di. Gjykatësi po thotë se edhe shteti paska prodhuar disa monedha si të miat.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

## "INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird




Në ora 18:20

## "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

## "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

## "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




**DASHI**

Edhe pse dita e sotme është më se e zakonshme, për ju do të shndërrohet në një ditë feste. Lajmi që do të merrni do t'ju gëzojë pa masë.



**DEMI**

Keni pranë vetes një mik të vërtetë që ju këshillon dhe ju rri pranë kur ju jeni në vështirësi. Sot është dita për t'i qenë mirënjohës.



**BINJAKËT**

Çdo gjë që ka të bëjë me shëndetin tuaj ose të familjarëve sot ju ka mërzitur disi. Kontrollat e shpeshta do të jenë ato që do t'ju qetësojnë.



**GAFORRJA**

Gjërat e vogla janë ato që do ta bëjnë lumturinë tuaj sot. Partneri është bashkudhëtari juaj në ëndrrën për të ardhme së bashku.



**LUANI**

Ato që thuhet në momentin e gabuar mund të prekin njerëz që për ju janë vërtet të rëndësishëm. Sot do të pendoheni për një fjalë të thënë.



**VIJGJËRESHJA**

Do t'ju duhet të jeni mjaft të programuar sot. Punët dhe agjenda e ngarkuar që keni nuk do t'ju lënë asnjë moment të lirë për t'u çlodhur.



**PESHORJA**

Një ditë e zhurmshme kjo e sotmja e karakterizuar nga humori dhe të qeshura pa fund. Familja është streha juaj e ngrohtë në çdo çast.



**AKREPI**

Arti dhe muzika janë ato që do t'ju shoqërojnë përgjatë gjithë ditës. Sot do të ecni me zemër dhe jo me arsye.



**SHIGJETARI**

Sot po shpresoni të mos keni vizita të paprogramuara, por do të ndodhë krejt e kundërta. Do t'ju ngatërrohen situatat dhe personat.



**BRICJAPI**

Biznesi dhe marrëveshjet janë pika juaj e fortë sot. Do t'ju kërkojnë ndihmë dhe do të dini të jepni atë që do t'ju kërkohej pa shumë problem.



**UJORI**

Entuziazmi juaj që fillon që në orët e para të mëngjesit do t'i lerë pa fjalë bashkëpunëtorët tuaj. Vitaliteti që ju shoqëron sot do të bëjë të merrni vendime interesante.



**PESHQIT**

Sot jeni aq komod sa nuk keni aspak dëshirë të reagoni apo të vendosni. Do ta lini gjithçka në dorë të të tjerëve dhe po ju pëlqen kjo ndjesi.



## George Clooney pëson aksident me motoçikletë në Itali



**G**eorge Clooney ka mbetur i lënduar nga një aksident rrugor në Sardenjë. Sipas shtypit italian, aktori hollivudian, i cili ndodhet në ishull për të xhiruar një film, ishte duke përshkruar

rrugën kombëtare në lokalitetin Costa Corallina, në provincën e Olbias, kur motori i tij skuter është përplasur me një makinë, ndërkohë që policia po verifikon shkaqet e këtij aksidenti.

## Cheryl shfaqet pas ndarjes nga Liam Payne



**P**as ndarjes nga Liam Payne, Cheryl nuk ishte shfaqur në publik. Pas kaq kohësh, ajo u rishfaq dje në Londër më në formë se kurrë. Ylli i popit dukej mahnitëse, veshur me një

fustan ngjyrë portokalli. 35-vjeçarja i tregoi këngëtarit 24-vjeçar Liam Payne se çfarë kishte humbur. Liam dhe Cheryl ishin bashkë prej dy vjetësh e gjysmë dhe janë prindër të një djali.



## Rita Ora, mahnitëse në setin fotografik

**R**ita Ora e gjen kohën për të bërë gjithçka. Pas fundjavës me familjen në Monako, 27-vjeçarja u rikthye në Londër për një set fotografik. Ajo ndau me ndjekësit në

rrjetin social "Instagram" disa fotografi duke treguar format e trupit. Aktualisht Rita ka një agjendë të ngjeshur, pasi ka nisur turneun e saj veror.

## Nuk mërzhitet nga fejesa e Justinit, Selena në krah të një mashkulli misterioz



**J**ustin Bieber ka konfirmuar lajmet se është fejuar me modeluesen Hailey Baldwin. Megjithatë, kjo gjë nuk e kishte tronditur ish të dashurën e këngëtarit kanadez, Selena Gomez. Kjo e fundit duket se nuk ka humbur shumë kohë dhe ka filluar

romancën e re. Bukuroshja amerikane është parë nën shoqëri të një mashkulli misterioz teksa hipnin të dytë në një jaht në Coney Island në Nju Jork. Me të njëjtin mashkull misterioz Selena ishte fotografuar edhe në muajin maj të këtij viti.





<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>						AFTËSIA E NJERIUT PËR TË KRIJUAR	LLOJ ZOGU KËNGËTAR	↓	FORTESË LIMIT	ERA E MIRË	SHTET I MADH NË AZI	<b>EPOKA E RE</b>	BASHKËT.	OLIVER NEUVILLE	FARMACI	PËREMËR PRONOR	
QË UA MBATH KËMBËVE NGA FRIKA												HATAJA AKTORI MORINA					
SËMUNDJE E RËNDË QË SHKAKTOHET NGA PARAZITË SHUMË TË VEGJËL (shq.)												ZULMË TËRHEQJE					
LLOJ GJARPRI														"RISANI" IZET FETAHAJ			
GJILANI, ARTANA								MBIEMËR CILËSOR	LETRARI CAMAJ ARIANITI (perkdh.)								EMËRIMI NË NJË POZITË
AKTORJA CAHANI												EMËR YNI MASHKULLI NANTES					
DJALI I VAJZËS										"N" para dy "A" KULAÇE (shq.)				"TORINO"			
PADITËSI I SOKRATIT												DY BASHKËTINGËLLORE "IRLANDA"			OLIVIER MARTINEZ ZANORE		
<b>EPOKA E RE</b>						MANEKINIA SHQIPTARE HITAJ	PËRCAKTIM, PËRKUFIZIM	URANI, KRABONI	SHTET AFRIKAN (pashq.)	PJESËTAR I NJË FISI ILIRI	FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE (shq.) THEMBRA E KËPUCËS		SHTET AZIATIK (pashq.) DËSHIROJNË				
SJELLJA E NJERËZISHME										ZANORE MJET I THJESHTË PUNE		AKTORI ISLAMI (shq.) ZANORE			ESTONIA, NORVEGJIA KËNGËTAR I NJOHUR AMERIKAN		
FLETA E VOGËL, KU MJEKU SHËNON LLOJET E BARNAVE										SULM E HAPUR			UNIVERSITY OF AUCKLAND			ZANORE FIGURË E RIPRODHUAR E NJË SENDI, SHËMBËLLTYRË	
AGIM TEJECI								LLOJ METALI LUTJE DREJTUAR ZOTIT (mysl.)		KËNGËTARJA ITALIANE PAUSINI		UGANDA POLITIKANI FINLANDEZ ... REHN		ANKESË SONDAZHI			
KËNGËTARJA E NJOHUR SHQIPTARE NË FOTO													ALEN NURI OSAKA		NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE FEMRAT LUFTËTARE (mit. greke)		
BIMË SHUM-ËVJËÇARE ME TRUNG TË TRASHË								BASHKËT.	KALIBËR I TYTËS SË ARMËS QË VEPRON ME GJALLËRI				SKAJI, QOSHJA ISMET MALAJ			ALBANOLOGIA DURHAM	
GURRA								AMPER, ALUMIN SHKRETËTIRA MË E THATË NË BOTË			DY ZANORE AUSTRIA, ISLANDA		AKTORJA AMERIKANE BASINGER FUTBOLLISTI FRANCEZ NASRI		ZHAN EDUARDSON DISIPLINË SPORTIVE		
<b>EPOKA E RE</b>						ZANORE I THAJ		BËRË ANKESË ANA VISI				LUMË NË SHQIPËRI TËRËSIA E ORENDIVE				BASHKËT. KËNGËTARJA ANGLEZE TANITA	
ZEMËRIM									ORGANIZATA MAFIOZE "..... KINEZE" FARISHTA					PERËNDIA			
QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI										ANTON PASHKU	KLUB FUTBOLLI ARGJENTINAS "... LORENZO"	SOLISTJA BYTYQI VENDËSI		PEZMATIM I VESHIT U PESHOVA			
ERMAL MAMAQI								LLOJ MOTOÇIKLETE QË PRODHOHET NË JAPONI AKTORI CRUISE (shq.)					QË S'KA TJETËR TË NGJASHËM ME TË TË LUTEM			ILAÇI	
BASHKËT.							GOTË PREJ BAKRI KAMION I VOGËL		PEIZAZH I GJERË SPEECH AUSTRALIA PATHOLOGY						ANITA BITRI PËREMËR VETOR		
<b>EPOKA E RE</b>						ISH PRESIDENTI AMERIKAN XHEFERSON NJË E RESHUR				SHEGË TENI ANDERSON			ENË E MADHE PËR TË MBAJTUR QUMËSHT TANTAL				
POTERË (sh.shq.)															RAST BASHKËT.		
PËREMËR PRONOR								KAMPIONI, ASI									DEGË E MJEKËSISË



# “Shtëpia e Frikës” në Moskë, historia sovjetike në miniaturë

Objektet e famshme të Moskës, Sheshi i Kuq, Kremli dhe kupolat e Katedrales së Shën Vasilit, janë mbushur me tifozët e Kampionatit Botëror të Futbollit që përfitojnë nga rasti të bëjnë vizita turistike mes lojrave. Por pak më tutje, turistët më kuriozë mund të gjejnë një kompleks apartamentesh që nuk bie në sy, historia e të cilit hedh dritë mbi ditët më të errëta të Bashkimit Sovjetik. Siç njofton nga Moska korrespondenti Henry Ridgwell, ajo histori është bërë përsëri subjekt i një debati të ashpër në Rusinë moderne.

Është një shtëpi sekretesh dhe hijesh, paranoje dhe ndëshkimesh të dhunshme. “Shtëpia mbi Bregun e Lumit” mishëron historinë e revolucionit dhe diktaturës në miniaturë. Ajo gjendet shumë pranë Kremliut dhe u ndërtua në vitin 1931 për të strehuar elitën qeverisëse të Bashkimit Sovjetik.



Brenda 500 apartamenteve të bllokut, Olga Trifonova menaxhon muzeun e kësaj shtëpie.

“Njerëzit që jetonin këtu, ishin të ashtuquajtur ‘Bolshevikë të vjetër’. Ishin njerëz të afërt me njëri-tjetrin, përsa i takon mentalitetit dhe ideologjisë, si edhe fatit të tyre”.

Ata bënë një jetë luksoze: teatër dhe bare në shtëpi, biblioteka dhe palestra. Por dëshira për t’u dukur

filloi të binte ndesh me idealet e revolucionit komunist.

Në mes të viteve 1930, udhëheqësi sovjetik Josif Stalin filloi ‘spastrimin e madh’ për të eliminuar ata që u quajtën “armiqtë të klasës punëtore”. Një milionë vetë u burgosën dhe 700 mijë u ekzekutuan. Banorët e Shtëpisë mbi Bregun e Lumit, dikur elita e revolucionit, ishin mes të parëve. Arrestimet dhe zhdukjet

krijuan një paranojë mbyttëse.

“Banorët e kompleksit nuk shkonin më për vizita tek njëri-tjetri. Nuk kishin më besim tek të tjerët”.

**800 banorë u arrestuan. Afro gjysma u ekzekutuan.**

Bashkëshorti i Olga Trifonovas, Yuri ishte rritur aty. Babai i tij u arrestua gjatë spastrimit dhe nuk u pa më, ndërsa e ëma u dërgua në Gulag. Në vitin 1976 Yuri Trifonov shkruajti një libër me kujtimet e tij, nga ku e merr emrin kompleksi i apartamenteve.

“Është një rrëfim për natyrën e frikës: se si frika e cungon njeriun përgjithmonë”.

Kujtimet e asaj frike, duket se po zbehen. Sipas një ankete të vitit të

kaluar, Stalimi është figura historike më e jashtëzakonshme e Rusisë.

Shtëpia mbi Bregun e Lumit nuk ka gjasa të jetë në krye të listës së objekteve turistike për shumë nga vizitorët e Kampionatit Botëror. Por vazhdon të qëndrojë në anë të lumit të Moskës si një relike e brutalitetit të Stalinit dhe ende ka disa nga pronat më të shtrenjta të Moskës.

Por nuk është e lehtë të gjenden blerës. Dmitry Taganov është me agjencinë e pasurive të patundshme “INCOM”

“Shumë blerës druhen nga e shkuara e errët e kësaj Shtëpie. Shumë njerëz pa dyshim e dine këtë, edhe ata që i takojnë brezit të ri”.

Një brez që po krijon në mendje imazhin e vet historik për Stalinin dhe trashëgiminë e komunizmit. (gazeta-Shqip.com)

## Historia e kafesë dhe 12 “sekrete” që nuk i keni ditur!

Është pija më e përhapur (pas ujit): Çdo ditë në botë konsumohen pothuajse 1,6 miliard filxhanë me kafe.

Kush ishin kultivuesit e parë dhe origjina e emrat. Doza vrasëse e kafes është rreth 100 filxhanë.

Ne të gjithë e konsumojmë kafe, disa më pak e disa më shumë. Madje shumë prej nesh nuk mund ta nisim ditën pa konsumuar fillimisht filxhanin e kafes. Por lind pyetja nëse e dini se përdorimi i saj sjell edhe benefite për shëndetin. Një kafe në mëngjes mund t’ju mbaj zgjuar dhe energjik për pjesën tjetër të ditës. Kafeina hyn në sistemin e gjakut tuaj dhe transmetohet deri tek truri ku më pas lirohet Dopamina. Kafja gjithashtu mund t’ju ndihmojë të keni një kujtesë më të fortë. Hulumtime të ndryshme kanë konstatuar se kafeina rrit metabolizmin tuaj duke djegur yndyrmat në trup.

### Pija e preferuar e gjermanëve

Jo birra, por në fakt kafeja është pija e preferuar e gjermanëve! Çdo gjerman pi rreth 149 litra kafe në vit, që do të thotë gati tre filxhana në ditë. Vendin e dytë e zë uji, kurse birtën me sa duket gjermanët nuk po e preferojnë më si më parë, sepse konsumi i saj është në rënie. Por sidoqoftë përkthyer në shifra, konsumi i birrës tek gjermanët është afro 100 litra për frymë në vit.

### Efekt stimulues në trup dhe në tru

Kafeja përmban kofeinë. Kjo substancë kimike intensifikon ritmin e

rrahjeve të zemrës, zgjeron enët e gjakut në trup, por ngushton ato në kokë. Kofeina shton energjinë, rrit efikasitetin dhe përqëndrimin dhe të mban më gjatë zgjuar. Por kafeja të bëhet edhe ves, kjo simptomë shfaqet me dhimbje koke, kur nuk pi kafe.

### Imazhi negativ për kafënë nuk përputhet me vlerat reale

Kafeja nuk është e dëmshme për shëndetin, përkundrazi pirja e katër apo më shumë filxhanave kafe në ditë të bën mirë, sipas Organizatës së kujdesit shëndetësor “Kryqi i gjelbër gjerman”. Kjo për faktin, se kafeja i gjallëron organet. Në bazë të studimeve të fundit: kafeja ul rrezikun ndaj sëmundjeve si ceroza, Alzheimeri dhe parkinsoni.

### Gjithçka nis me qershinë e kafesë

Kafeja e ka origjinën nga Etiopia në Lindje të Afrikës. Atje kaçubet e kafesë rriten deri në lartësinë prej katër metrash. Ato formojnë frutin, një njihet si qershia e kafesë dhe derisa fruti piqet e ndryshon ngjyrën nga e gjelbër, në të verdhë e në fund bëhet e kuqe. Ky frut përmban dy fara, pra kafënë.



### Korrja dhe përgatitja

Qershitë e kafesë vilen kryesisht me dorë dhe më pas thahen. Për t’u tharë ato lihen për disa javë në Diell duke u përzierë rregullisht për t’u kthyer nga të gjitha anët. Ose ato pastrohen me ujë dhe i nënshtrohen procesit të fermentimit derisa fara të shkëputet prej masës së frutit. Kësisoj në fund mbetet vetëm fara e kafesë.

### Kafeja është gati!

Pas tharjes, farave duhet t’u hiqet edhe një cipë e hollë. E pas kësaj ato piqen dhe bluhën. Në varësi të bimës enmërtohet edhe lloji i kafesë, si për shembull: “kafe-arabica” vjen nga bima “coffea-arabica”, ose “kafe-robusta” nga “coffea canephora”.

### Brazili eksportuesi më i madh i kafesë

Druri i kafesë ka nevojë për një klimë konstante pa temperatura

me luajtje ekstreme nga ngrica në vapë. Kafeja mbillet kryesisht në vendet ekuatoriale në mbarë botën. Prodhuesi kryesor i kafesë padyshim është Brazili, i pasuar nga Vietnami dhe Kolumbia.

### Hamburgu – Qendra e importit

Çdo vit vilen rreth tetë milionë ton kafe në të gjithë botën. Pjesa më e madhe exportohet. Porti i Hamburgut është qendra më e madhe e importit të lëndës së parë të kafesë për tregun gjerman, skandinav dhe tregun e Europës Lindore.

### Keq për biodiversitetin

Tradicionalisht bima e kafesë është mbjellë gjithnjë nën hijen e pemëve të mëdha. Në këtë mënyrë janë ruajtur mjedisi natyror dhe biodiversiteti. Por, konsumimi i kafesë po shënon rritje në gjithë botën. Për të rritur rendimentin e prodhimit, shumica e pronarëve të planta-

cioneve po e kultivojnë kafënë si monokulturë.

### Alternativë: Kafeja ekologjike

Në shumë vende zonat pyjore po shpërbëhen për t’i hapur vend plantacioneve të reja për kultivimin e kafesë. Por nga përdorimi i pesticideve dhe herbicideve për të shmangur nga plantacionet parazitët dhe barërat e këqia dëmtohet mjedisi. Kafeja ekologjike është një alternativë më e favorshme për mjedisin, por kuota e saj në treg është ende shumë e ulët.

### Mbrojtje për kafënë e egër

Kafeja kultivohet në mbarë botën, por për ironi “kafeja e egër”, e cila gjendet në Etiopi kërcënohet të zhduket. Ajo rritet në pyje ku bie shumë shi, në rajonin Kaffa, por atje ajo vuan prej shpyllëzimit pa kriter. Përmes programesh të ndryshme synohet që të ruhet ekzistenca e kësaj kafeje.

### Kafe për të regjirit mirë

Njëra ndër kafetë më të shtrenjta, “Black Ivory Coffe” (kafeja fildishi i zi), vjen nga Tajlanda. Kokrrat e kësaj kafeje përpara se të piqen kalojnë nëpër zorrët e një elefanti. Kokrrat që i rezistojnë qarkullimit në procesin e përpunimit organik në trupin e elefantit përzgjidhen më pas nga jashtëqitja e tij. E pra kujt i pëlqen kjo, i bëftë mirë...

(gazeta-Shqip.com)



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

CROATIA - ENGLAND

GG

VEJLE V HOBRO

1

HOME UNITED - YOUNG LIONS

1

## Më 28 korrik ndeshja e parë në stadiumin e Prishtinës

Ministri Kujtim Gashi ka thënë se ndeshja e parë testuese në stadiumin e Prishtinës do të zhvillohet më 28 korrik. "Lojën e parë testuese do ta kemi më 28 korrik. Para kësaj date ndoshta do ta kemi edhe një ndeshje miqësore testuese në mes të Federatës, artistëve dhe politikanëve, pastaj ta inaugurojmë që të jetë i gatshëm për zhvillimin e lojërave", ka deklaruar Gashi



### Gashi: Komuna vendos për emrin e stadiumit

Kujtim Gashi gjatë vizitës në stadium ka folur edhe për atë se a do ta mbajë ky stadium emrin e legjendës së futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri. Sipas tij, të gjithë janë pajtuar që stadiumi ta mbajë emrin e Fadil Vokrri. "Ju e dini se stadiumi është në pronësi të komunës. Edhe vendimin për vendosjen e emrit të Fadil Vokrri e merr Kuvendi Komunal i Prishtinës. Të gjithë kemi propozuar dhe jemi pajtuar që ta mbajë emrin Fadil Vokrri dhe kemi pajtueshmëri edhe nga kryetari i komunës dhe lidhshipi komunal që ta mbajë emrin e Vokrri", ka thënë Gashi.

korrik. Para kësaj date ndoshta do ta kemi edhe një ndeshje miqësore testuese në mes të Federatës, artistëve dhe politikanëve, pastaj ta inaugurojmë që të jetë i gatshëm për zhvillim-

in e lojërave", ka deklaruar Gashi. Ndërsa edhe kryetari i ri i FFK-së, Agim Ademi, bërë me dije se ndeshjet me ekipin A dhe klubet do të fillojnë nga muaji shtator.

## Drita mposhtet nga Malmo, Shkëndija mposhti TNS-në

MITROVICE, 10 KORRIK - Kampionia e Kosovës në futboll, Drita, ka pësuar humbje të martën në mbrëmje nga Malmo (0-3), në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin olimpiq "Adem Jashari" në Mitrovicë, në kuadër të kualifikimeve për Ligën e Kampioneve. Dy golat ekipi suedez i shënoi në pjesën e parë nëpërmjet Carlos Strandberg (13) dhe Arnor Ingvi Traustason (39), kurse Markus Rosenberg (82) e

shënoi golin e tretë. Drita në këtë edicion ka shkëlqyer në arenën ndërkombëtare, pasi ka mposhtur Santa Colomanin e Andoras me rezultat 2-0 dhe Lincoln Red Imps FC nga Gjibraltari me rezultat 4-1. Skuadra tjetër shqiptare, Shkëndija e Tetovës, e deklaroi TNS-në, duke e mposhtur me rezultat 5-0. Katër gola për Shkëndijen i shënoi Besart Ibrahim, kurse një tjetër Izair Emiri.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 KORRIK - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, të martën e ka vizituar Federatën e Futbollit të Kosovës dhe e ka uruar Agim Ademin për detyrën e re në krye të FFK-së. Me këtë rast numri një i MKRS-së i ka ofruar përkrahje kryetarit Ademi dhe ka shfaqur optimizëm se ai do ta vazhdojë rrugën e kryetarit të ndjerë, Fadil Vokrri. Ndërsa kryetari Ademi e ka falënderuar ministrin Gashi dhe është shprehur i hapur për bashkëpunim. "E falënderuam për projektet, por edhe nderin dhe respektin që i është bërë

Fadil Vokrri", ka thënë Ademi. Më pas Gashi dhe Ademi inspekuan punimet finale në stadiumin e Prishtinës. "Çdo ditë e imja e punës, çdo orë ka qenë pjesë e përkushtimit për finalizimin e këtij projekti kapital që është për futbollin në Kosovë. Falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët të cilët janë marrë me këtë projekt, punëtorët, kolegët, po ashtu edhe Federatën e Futbollit dhe të gjithë inspektorët e UEFA-s. Kjo është një ditë jashtëzakonisht e rëndësishme për sportin e Kosovës, për futbollin në veçanti, që më në fund po arrijmë të dorëzojmë një prej stadiumeve më të bukura në rajon falë investimit të madh rreth 9

milione euro që e ka bërë Ministria e Sportit. Ne e kemi konsideruar si një prej projekteve më të mëdha kapitale. Uroj që gjithçka të shkojë mbarë brenda këtyre dy javëve", ka thënë ministri Gashi. "Lojën e parë testuese do ta kemi më 28

## Franca kualifikohet në finale të Botërorit

MOSKË, 10 KORRIK - Kombëtarja e Francës është kualifikuar në finale të Kupës së Botës "Rusi 2018", pasi në gjysmëfinale e ka mposhtur Belgjikën (1-0). Goli i mbrojtësit të Barcelonës, Samuel Umtitit, i kualifikon francezët në finale të Botërorit pas plot dymbëdhjetë vjetësh. Në pjesën e parë Belgjika dominoi për njëzetë minuta, por forma e kapitenit Hugo Lloris ruajti të paprekur rrjetën e Francës dhe minutë pas minute "gjelat" u rritën në dëm të kundërshtarit. Edhe francezët kishin rastet e tyre në pjesën e parë, por Pavard, Giroud dhe Mbappe nuk arritën të shënojnë. Në minutën e gjashtë të pjesës së dytë ndodhi një episod kyç për gjysmëfinalen. Gjatë një goditje nga këndi, Samuel Umtiti fitoi duelin ajror me



Fellaini dhe tundi rrjetën me një goditje të saktë me kokë, që nuk i dha mundësi reagimi portierit Thibaut Courtois. Kjo ishte hera e parë për Francën, që nga viti 1998, që shënojnë tre mbrojtës në një Botëror. Atëherë gjenin golin Thuram, Lizarazu dhe Blanc, këtë herë Pavard, Varane dhe Umtiti. Belgjika provoi të

sulmonte, por pa prishur festën e ekipit të Didier Deschamps, që bëhet gati ta shkruajë historinë. Shqiptarit Adnan Januzajt nuk i është dhënë rasti në asnjë minutë të luajë për Belgjikën në këtë ndeshje. Në finalen e Moskës, më 15 korrik, Franca do të ndeshet me Anglinë ose Kroacinë.

## Ronaldo nënshkruan me Juventusin

TORINO, 10 KORRIK - Juventusit do të jetë skuadra e re e yllit portugez Cristiano Ronaldo. Presidenti i Realit të Madridit, Florentino Perez, ka dhënë lejen për trans-

ferimin e Ronaldos në Torino për shumën 105 milionë euro. "Ka ardhur koha të hap një kapitull të ri në jetë dhe për këtë kërkova transferimin. Iu lutem tifozëve të

më kuptojnë, pasi kanë qenë të mrekullueshëm në këta nëntë vjet. Realit ka zemrën time dhe për këtë dua t'i falënderoj të gjithë. Kam reflektuar shumë, por tani

koha është për një cikël të ri", ka thënë Ronaldo, i cili ka luajtur për skuadrën e Realit nga viti 2009. Ronaldo ka arritur ta fitojë pesë herë "Topin e Artë".





## Prishtina kërkon rezultat pozitiv ndaj Fola Esch

PRISHTINË, 10 KORRIK - Skuadra fituese e Kupës së Kosovës në futboll, Prishtina, do të përballet sot (e mërkurë) me skuadrën e CS Fola Esch në kuadër të Ligës së Evropës. Sulmuesi Ahmet Januzi e ka vlerësuar mjaft shumë skuadrën

kundërshtare, por është optimist se Prishtina mund të marrë rezultat pozitiv në këtë ndeshje. "Meqë e kemi kaluar raundin preliminar, tani është shumë e rëndësishme për ne që të paraqitemi sa më denjësisht edhe në raundin e parë duke

shpresuar se do të na përcjellë suksesi edhe në këto dy ndeshje të radhës. Kemi përballë kundërshtar që nuk është për t'u nënvlerësuar. Ma merr mendja shumë më i fortë se Europa FC por, sido që të jetë, ne do ta respektojmë çfarëdo kundërshtari që

do të jetë, më i fortë apo më i dobët, nuk ka rëndësi. Do të udhëtojmë ta japim maksimumin me qëllim të kalimit të raundit. Ky është synimi ynë, të paktën", ka thënë Januzi për faqen zyrtare të Prishtinës. Ndeshja në mes të CS Fola Esch dhe



Prishtinës zhvillohet nga ora 18:00 në Luksemburg.

## Lirohet 'Ballist' Morina

TIRANË, 10 KORRIK - Tifozi i njohur shqiptar, Ismail Morina, i njohur si "Ballisti", është liruar më në fund nga burgju. Vetë "Ballisti" ka konfirmuar lajmin për lirim nga burgju, duke e postuar një foto në faqen e vet zyrtare në "Facebook".

Ismail Morina ishte arrestuar më 10 qershor të vitit të kaluar në Kroaci, pas një fletarrestimi ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet serbe. Ai kërkohet nga Serbia, i akuzuar për ngritjen e dronit me flamurin "Autochthonous" mbi stadiumin e Beogradit, gjatë ndeshjes Serbi - Shqipëri, në tetor të 2014-s.

Në Kroaci, Ismail Morina iu nënshtrua një sërë procesesh gjyqësore për ta shmangur ekstradimin në burgjet serbe, ndërsa në çështje u investuan edhe institucione politike të Shqipërisë, Kroacisë dhe Serbisë. Më 28 mars të këtij viti, Kroacia vendosi ta transferojë Morinën drejt Italisë, ku edhe vijoi beteja



gjyqësore për lirim të tij përfundimtar. Mesditën e së martës Ismail Morina postoi një foto me konsullin shqiptar në Bari,

Adriatik Haskaj, ndërsa falënderon autoritetet shqiptare, italiane dhe kroate, që ndihmuan për lirim të tij.

## Kroaci - Angli, në Moskë për ta shkruar historinë



MOSKË, 10 KORRIK - Kroacia dhe Anglia, që kanë pritur për vite të tëra ta harrojnë shijen e hidhur të humbjes në gjysmëfinale të Kampionatit Botëror, do të përballeten sot (e mërkurë) në Moskë, me synimin për të bërë një hap gjigant në historinë e futbollit. Hera e fundit që Anglia ka luajtur në këtë fazë të Kupës së Botës ishte viti 1990 dhe "luanët" u mposhtën nga Gjermania me penallti, në Torino, ndërsa Kroacia, në Botërorin e parë që mori pjesë si shtet i pavarur, u mposht me përmbysje në gjysmëfinale, 2-1 nga Franca në vitin 1998. Anglia dhe Kroacia kanë ardhur në

### FORMACIONET E MUNDSHME

**Kroacia:** Subasiq; Vida, Lovren, Corluca, Strinic; Rakitiq, Brozovic, Rebiq, Modriq, Perisic; Mandzukic.  
**Anglia:** Pickford; Walker, Stones, Maguire; Trippier, Henderson, Young; Lingard, Alli; Kane, Sterling.

Rusi si skuadra të forta, por jo si pretendentet kryesore për trofeun, por rrugës gjërat kanë ndryshuar. Kroacia fitoi 3-0 ndaj Argentinës në fazën me grupe, duke dhënë sinjalin e forcës së saj, bazuar edhe te inteligjenca dhe lidhshipin e Luka Modriqit. Kroatët u kualifikuan me penallti në dy raundet me eliminim ndaj Danimarkës dhe Rusisë, duke treguar se janë të ftohtë edhe

psikologjikisht. Edhe Anglia pati nevojë për penalltitë që ta eliminonte Kolumbinë në 1/8-t e finaleve, më pas "hoqi qafe" Suedinë me rezultatin 2-0, shumë lehtësisht. Anglia ka fituar katër nga shtatë ndeshjet e luajtura kundër Kroacisë, përfshirë suksesin 5-1 në sfidën e fundit zyrtare, në eliminatoret e Kupës së Botës 2010.

### SHKURT

#### Të mëdhenjtë nuk gabojnë në Wimbledon

Të mëdhenjtë e tenisit botëror nuk gabuan në ndeshjet e tyre të raundit të katërt të Wimbledonit. Federeri, Nadali e Djoković u kualifikuan për në çerekfinale të turneut londinez pa hasur vështirësi. Roger Federeri eliminoi në ndeshjen e tij francezin Mannarino, duke e mundur 3-0. Seti i parë nuk kishte histori dhe Federeri e mbylli 6-0. Më të ekuilibruar ishin dy setet e tjerë që gjithsesi u fituan nga zvicerani 7-5 dhe 6-3. Nadali iu përgjigj menjëherë rivalit dhe mikut të tij Federer. Tenisti spanjoll që tashmë e ka të siguruar vendin e parë në renditjen ATP edhe në përfundim të Wimbledonit mundi Jiri Vesely me rezultatin 3-0 për t'u kthyer në çerekfinalen e këtij eventi pas shtatë vjetësh. 6-3;6-3 dhe 6-4 ishte rezultati i seteve të fituara nga Nadali që ishte gjithnjë në kontrollin e lojës ndaj kundërshtarit të tij. Edhe Djoković vazhdon të shfaqet në një formë të mirë. Ashtu sikurse dy rivalët e tij, edhe ish-numri 1 i botës fitoi me lehtësi ndeshjen e radhës, atë me Khachanovin me rezultat 3-0. Djoković i nisi ngadalë ndeshjen, por arriti ta vendosë diktatin e tij duke i fituar setet 6-4;6-2;6-2 dhe në çerekfinale do të luajë me Kei Nishikorin.

#### Lakersat prezantojnë Jamesin

Ylli i NBA-së, LeBron James, edhe zyrtarisht është basketbollisti i ri i Los Angeles Lakersit. "Mbreti" James ka firmosur kontratë katërvjeçare nga e cila do të përfitojë 154 milionë dollarë, kurse ka pozuar edhe me fanellën e vet të re. Sikurse në të kaluarën edhe te Lakersat, James do ta mbajë fanellën me numrin 23.

#### Veteli: Fituam në shtëpinë e rivalëve

"Fitorja në Silverstone është shumë e rëndësishme, pasi ishte një sukses në fushën e rivalëve tanë, ndaj jemi të kënaqur për këtë triumf", ka thënë Sebastian Vettel, që tashmë është shkëputur tetë pikë nga rivali më i afërt, Lewis Hamiltoni. "Makina e sigurisë shkurtisi letrat, por ia dola mbanë të parakaloja Bottasin. E kalova në një pikë që edhe ai vetë nuk e priste. Për fat, çdo gjë shkoi mirë, edhe pse ishte një duel në limite, pasi kthesa ishte shumë afër. Adrenalina ishte e madhe, gara po ashtu dhuroi shumë emocione e surpriza, por makina ishte e shpejtë dhe gjërat funksionuan ashtu si duhet. Starti i garës ishte i rëndësishëm, ndaj jam i lumtur që ia dolëm mbanë. Kjo është meritë e gjithë skuadrës. Tani na duhet të punojmë që të fitojmë edhe në Gjermani", ka thënë Veteli.


#### Torresi prezantohet te Sagan Tosu

Ish-sulmuesi i Liverpoolit, Chelsea dhe Kombëtares së Spanjës, Fernando Torres, ka nënshkruar kontratë me skuadrën japoneze Sagan Tosu. Kontrata e Torresit me Atletico Madridin përfundoi këtë verë, kurse paraqitja e tij për këtë skuadër ishte në finale të Evropa Ligës ndaj Marseillet. Torresi gjatë karrierës së tij futbolistike e ka fituar Kampionatin Botëror dhe Kampionatin Evropian si dhe Ligën e Kampionëve. "Kam pasur oferta nga Franca, Gjermania dhe Spanja, por në asnjë moment nuk kam menduar kurrë të shkojë në një ekip tjetër evropian. Doja një sfidë të re dhe krejtësisht të ndryshme", ka thënë Torresi.

#### Mandzukiqi kërkon finalen me Kroacinë


Sulmuesi Mario Mandzukiq është gati ta japë maksimumin në ndeshjen gjysmëfinale ndaj Anglisë për ta arritur kualifikimin në finalen e madhe të Kupës së Botës. "Mos u shqetësoni, unë dhe skuadra kemi ende për të dhënë ndaj Anglisë. Do të luftojmë deri në fund dhe, në nëse humbasim, askush nuk mund të na kritikojë. Nuk e di se ku e gjej forcën. Kujtoj disa ekspertë që përpara fillimit të kampionatit thanë se Mandzukiqi nuk është mirë për shkak të moshës. Mesa duket paskan pasur të drejtë, pasi tani kemi një të ri, më i mirë se Mandzukiqi që njohin. Unë përpiqem gjithmonë të jap më të mirën për klubin dhe vendin tim", ka deklaruar Mandzukiqi.





**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

**KOMUNA E KLINËS**  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

---

Zyra e Personelit  
02Nr. \_\_\_\_\_/2018  
Klinë, 10.07.2018

Komuna e Klinës, duke u bazuar në nenin 8të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, si dhe udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, shpall:

**KONKURS PUBLIK**  
**Për plotësimin e vendeve të lira të punës:**

- Mjek të praksës së përgjithshme - 2 Ekzekutues për kohë të caktuar 1 vjeçare
- Stomatolog - 1 ekzekutues për kohë të pacaktuar

**Për të dy pozitat**  
Mbiqëqyrësi: Drejtori i QKMF-së "NënaTerezë" Klinë  
Koefficienti – paga për të dy pozitat: 565.51 €  
Orari i punës: i plotë sipas Ligjit të Punës  
Vendi: Klinë-QKMF, QMF, AMF  
Kohëzgjatja e Emërimit: Sipas Ligjit të Punës.  
Numri i referencës së vendit të punës: Ref 08/2018

**Qëllimi dhe rezultatet:**  
Te organizoj punën në QKMF, QMF dhe AMF

---

**Detyrat dhe përgjegjësit e mjekut të praksës së përgjithshme:**

- mbanë evidencën e dokumentacionit mjekësor,
- jep udhëzime me shkrim dhe me gojë për trajtime të pacienteve,
- mbanë kujdestarin sipas radhës,
- merr pjesë në hartimin e planit dhe programit të punës,
- përshkruan dhe administron tretmanet, medikamentet dhe aplikon masat tjera,
- këshillon pacientet lidhur me dietën, ushtrimet, higjienën dhe shëndetin në përgjithësi,
- raporton lindjet, vdekjet dhe sëmundjet ngjithëse tek autoritetet qeveritare.

**Detyrat dhe përgjegjësit e Stomatologut:**

- mban evidencë të rregullt të dokumentacionit mjekësor,
- jep udhëzime me shkrim dhe gojë,
- kontrollon punën e asistentit dhe bën dirazhimin e pacientit,
- bënë vizita sistematike të grupmoshave 7-11-14,
- bënë mjekimin e dhëmbëve të qumështit, të përershëm si dhe heqjen e tyre gangrenoz.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

**Shkollimi i kërkuar: Për mjek të praksës së përgjithshme**  
Diploma Universitare, Fakulteti i Mjekësisë-drejtimi i përgjithshëm, licencë pune dhe stazhi i obliguar profesional,

**Shkollimi për Stomatolog:**  
Fakulteti i Mjekësisë drejtimi Stomatologji, licencë pune dhe stazhi i obliguar profesional

**Aftësitë:**

- shkathtësi të mira organizative,
- aftësi për të krijuar raporte të mira ndërpersonale,
- të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme të vetorganizimit,
- aftësi për të punuar në ambiente multi-etnike.

**Mënyra e Aplikimit:**  
Formularët për Aplikim mund të merren në **Zyrën Komonale të Personelit në Komunën e Klinës** aty ku edhe është bërë shpallja e rekrutimit dhe dorëzohen po në të njëjtën zyrë.  
Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni në Zyrën e Personelit, përmes **telefonit fiks 039 471 550 ose telefonit mobil 044/887659.**  
**Shpallja, mbetet e hapur 15 ditë** nga dita e publikimit në mjete të informimit publik, dokumentet e pakompletuara dhe pas afatit nuk pranohen.  
Ligji i Punës Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore dhe nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Shefi i Personelit  
Xhavit Dauti

---

**Kancelaria Osoblja**  
02Br. \_\_\_\_\_/2018  
Klina, 10.07.2018

Opština Klina, na osnovu člana 8 Zakona Rada br. 03/L-212 objavljuje sledeci:

**JAVNI KONKURS**  
**Za popunjavanje slobodnih radnih mesta**

- Lekar Opšte Prakse - 2 pozicije za određeni vremenski rok
- Stomatolog - 1 pozicija za neodređeni vremenski rok

**Za obe pozicije**

**Nadzornik:** Direktor GCPM  
**Koeficient – dohodak:** 565.51€  
**Radno vreme:** Puno, po Zakonu Rada  
**Mesto:** Klina-GCPM, CPM, APM  
**Trajnost imenovanja:** Po odredbama Zakona Rada

**Broj reference radnog mesta:** Ref 08/2018

**Cilj i rezultati:**  
Da organizuje rad u GCPM, CPM, APM

**Duznosti i odgovornosti lekara:**

- održava evidenciju medicinske dokumentacije,
- daje pismene i verbalne upustva za dalji tretman pacijenata,
- vrsi dezurstvo po datom redosledu,
- učestvuje u pripremi plana i programa rada,
- prepisuje i upravlja date upustva, lekove kao i upravlja druge mere,
- savetuje paciente o zdravlju i licnoj higijeni,
- izvestava o novim porođajima, smrtnima i zbraznm bolestima.

**Duznosti stomatologa**

- održava evidenciju medicinske dokumentacije,
- daje pismene i verbalne upustva za dalji tretman pacijenata,
- brine o zdravlju pacijenata,
- kontrolise rad pomocnika,
- vrsi redovne kontrole pacijenata 7-11-14 godina starosti,
- leci mlečne zube, stalne kao i izvadjenje gangrenskih zubova
- ostale postavu u domenu stomatologa.

**Uslovi učešća na regrutovanje:**

**Trazena stručna sprema lekara:** Diploma Medicinskog Fakulteta-opšti smer,odgovarajuca radna licenca i profesionalno iskustvo


**Trazena strucna sprema stomatologa:** Diploma Medicinskog Fakulteta-stomatoloski smer,odgovarajuca radna licenca i profesionalno iskustvo

**Trazene ostale sposobnosti za obe pozicije:**


- Dobre sposobnosti o organiziranju rada,
- Sposobnost da stvara dobre međuljudske odnose,
- Da ima odlične sposobnosti organizovanja,
- Sposobnost da radi na multietničke ambiente.

**Način apliciranja:**  
Formulari za aplicovanje mogu da se uzimaju u **Kancelariju za Osoblje br. 6**, gde je i objavljen oglas regrutovanja i predaju se u istu Kancelariju, za detaljne informacije možete da kontaktirate Kancelariju za Osoblje **preko tel. 039-471-550 ili mobilni: 044/887659.**  
**Oglas ostaje otvoren 15 dana** od dana objavljivanja u sredstvima javnog informisanja. Nekompletna dokumentacija i ona što stiže posle roka ne uzimaju se u obzir.  
Zakon Rada Kosova pruža ravnopravne mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova i dočekuje sve aplikacije ženskog ili muškog pola i svi zajednice Kosova.

**Šef Kancelarije Personala**  
**Xhavit Dauti**



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government  
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



**AAPSK**  
Agencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agencia za Upravljanje Zaplenjenom ili Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestered or Confiscated Assets

Agencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agencia za Upravljanje Zaplenjenom ili Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestered or Confiscated Assets

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 22 paragrafi 3 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbimit Civil, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, shpall këtë:

**NJOFTIM**

Njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar se konkursi i shpallur më datën 26.06.2018 për Pozitat: Zyrtar i Lartë për Integritet Evropian- Rishpallje - I (një vend pune) me numër të Referencës RN00003338, dhe Asistent/e Ekzekutive , I (një vend pune) me numër të Referencës RN00003392, në Gazetën ditore "EPOKA E RE" dhe në web - faqen e Ministrisë së Drejtësisë, vazhdohet edhe për shtatë (7) ditë kalendarike, nga data: 11.07.2018 deri më datën 17.07.2018.

Të gjithë Kandidatët të cilët kanë aplikuar në afat dhe procedure të rregullt për këto Pozita, nuk kanë nevojë për ri-aplikim.

---

U skladu sa Zakonom Br. 03/L-149 za Civilnu Službu, Republike Kosova, i člana 22, tačka 3, Uredbu Br . 02/2010 o Proceduri Rekrutiranja u Civilnoj Službi, Agencija za Administraciju Zaplenjene ili Konfiskovane Imovine objavljuje sledeće:

**O B A V E Š T E N J E**

Obaveštavaju se svi zainteresovani Kandidati da Konkurs objavljen dana **26.06.2018** za Poziciju: **Visoki službenik za evropske integracije** - Ponovo objavljuje 1 (jedno) radno mesto sa broj referencije **RN00003338**, I Poziciju : **Izvršni asistent** - I (jedno radno mesto) radno mesto sa broj referencije **RN00003392**, na dnevnu novinu "EPOKA E RE " i u web-stranu Ministarstva Pravde, produžen je za sedam (7) kalendarskih dana, od : 11.07.2018 do 17.07.2018.

Svi Kandidati koji su u regularnom roku i postupku aplicirali za ove Pozicije, nemaju potrebu za ponovno apliciranjem.

---

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Bahri Shala, shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hamz Jashari" Skenderaj.

► Afrim Abazi , shpallë të pavlefshme dëftesën e kasës së VIII (8) të shkollës fillore "Zenel Hajdini" Prishtinë.

► Gentian Abazi, shpallë të pavlefshme dëftesën e klasës së IX (9) të shkollës fillore "Asim Vokshi" Prishtinë.

► Fisnik Uka, shpallë të pavlefshme dëftesat e klasës: -X-, -XI-, -XII- si dhe diplomën e Kolegjit "Mehmet Akif" në Lipjan.

► D.P.T. "A.B.C" shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit më numër: 70087329.

► Festina Hoxhaj shpallë të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.

► Andi Gashi shpallë të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.

► Jaser Abdullaj shpallë të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.

► Seprand Gashi shpallë të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.

► Albion Kastrati shpallë të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.

► Mentor Rizanaj shpallë të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Naum Frasheri" Vlashnje.

► Edita Mytqi shpallë të pavlefshme diplomën SHMLT "11Marsi" Prizren.

► "GASTRO" Sh.PK me seli në Prishtinë, shpallë të pavlefshme certifikatën e TVSH-së me numër: 330367129.

► Urgjentisht kërkoj një banës me qera për një person të huaj, Banesa duhet të jete jo shumë larg qendrës, mundësisht tek "Qafa" ose "Tophane" Duhet të ketë dy dhoma gjumi, të jete e mobiluar bukur. Çmimi deri 300 euro. Për info: Tel 049-472-770

► Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perllashi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift në Fushe Kosove. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë të jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira në Prishtinë, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehtë qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

#### MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ministria e Administratës Publike bën:

#### Shpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Ministria e Administratës Publike /Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
Titulli i punës:	Përkthyes/e Shqip - Serbisht dhe anasjelltas (1 vende pune)
Numri i referencës:	MAP/DFSHP - 1 - 2018 /MSHV
Tarifa e shërbimit:	Koeficienti 7
Raporton te:	Udhëheqësi i Divizionit
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	3-6
Orari i punës:	I plotë, 40 orë në javë
Lokacioni:	Prishtinë "Ndërtesa ish Rilindja"

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përkthim profesional i materialeve zyrtare nga gjuha shqipe në serbe dhe anasjelltas;
- Përkthim simultant dhe konsektiv nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas në takime të niveleve të ndryshme të ministrisë;
- Përkthim konsektiv në seminare, komisione dhe takime të ndryshme etj;
- Përkthim administrativ duke i shtypur në kompjuter në formë të drejtë drejtshkrimore;
- Korrigjon dhe dërgon shkresa e materiale sipas nevojave të Ministrisë;
- Protokolli materialet e përkthyer në librin e regjistrimit dhe i arkivon në mënyrë elektronike;
- Bashkëpunon me zyrtarët tjerë në përbushjen sa më të suksesshme të detyrave duke u konsultuar me eprorin;
- Ofron dhe kryen përkthime duke bashkëpunuar me njerëz të kulturave të ndryshme, besimeve fetare të ndryshme, kundër vështrimeve politike të mbajta paanësinë dhe objektivitetin;
- Të pranohet kushtet e vështira të komunikimit pa kufizim kohor në raste të përkthimeve të ndryshme;
- Të ketë njohuri në përdorimin e mjeteve për përkthim (teknikat e përkthimit);
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së eprorit;

#### Kualifikimi Përvoja dhe Shkathtësitë e kërkuara:

- Shkolla e mesme – fakulteti përparësi;
- Së paku 2 vite përvojë pune profesionale;
- Zotim i shkëlqyeshëm i gjuhëve shqipe dhe serbe;
- Shkathtësi komunikimi, në mënyrë verbale dhe në të shkruar, me qëllim që të jetë i aftë të komunikoj;
- Njohuri të mira të punës me kompjuter
- Aftësi në përbushjen e detyrave dhe punëve me ngarkesë, dhe përcaktimin e prioriteteve;

Ministria e Administratës Publike mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

#### Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim e të drejtave civile dhe politike, të kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

**Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi mbetet i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në ueb faqen e MAP-it dhe shtypin ditor.

**Paraqitja e kërkesave:** Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e MAP-it, zyrën nr.320 kati i III-të ose mund të tërhiqen nga web faqja e MAP-it në adresën <http://map.rks-gov.net/> dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: Ndërtesa e ish Rilindjes kati i III-të nr. zyrës 320 - Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 - 16:00. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/200 30 002.

**Aplikacionit duhet t'i bashkohet:** Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Datat e mbajtjes së intervistave për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë konkurs, do të publikohen vetëm në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Administratës Publike.

Na osnovu člana 12, stav 4 Zakona Br. 03/ L -149 za Civilnu Službu Republike Kosovo, Zakon Br. 04/L077 Za Odnose Obaveza, Ministarstvo Javne Uprave, objavljuje:

#### Javni konkurs o Dogovoru za Posebne Usluge

Naziv Institucije	Ministarstvo Javne Uprave /Departman Finansije i Opšte Usluge
Titula radnog mesta :	Prevodilac Albanski-Srpski i obratno (1 radna mesta )
Broj referenci je :	MJU-DFOU - 1 - 2018 god./DPU
Tarifa usluge :	Koeficijenta 7
Izveštava :	Rukovodilac Divizije
Vrsta Ugovora :	Dogovor za Posebne Usluge - (DPU)
Trajanje ugovora:	3-6
Radno vreme :	Puno radno vreme , 40 sati nedeljno
Lokacija	Priština "Dom Štampe Rilindja"

#### Zadaci i odgovornosti :

- Profesionalni prevod službenih materijala sa albanskog na srpski jezik i obrnuto;
- Simultant i konsektivni prevod sa albanskog na srpski jezik i obrnuto na sastancima različitih nivoa ministarstva;
- Konsektivno prevodenje na seminarima, komisijama i sastancima itd.
- Administrativno prevodenje pritisnuti u kompjuteru u pravom formatu i pravopisu
- Ispravljuje i šalje dopise i materijale u skladu sa potrebama Ministarstva;
- Protokolira prevedene materijale u registarskom knjigu i arhivira na elektronski način
- Sarađuje sa drugim službenicima u uspešnom obavljanju dužnosti konsultujući sa naredenim;
- Pružna i obavlja prevode saradnjom sa ljudima različitih kultura, različitim religijskim vernicima, protiv političkih stavova radi održavanja nepristrasnosti i objektivnosti;
- Prihvatanje teških uslova komunikacije bez vremenskog ograničenja u slučaju različitih prevoda;
- Imati znanja o upotrebi opreme za prevodenje (tehnika prevodenja);
- Vršiti druge poslove na zahtev nadzornika;

#### Kvalifikacija Radno iskustvo i Potrebne veštine :

- Srednja Škola -Prednost – Fakultet.
- Najmanje 2 godine profesionalnog iskustva;
- Odlučna posvećenost albanskom i srpskom jeziku;
- Veštine komunikacije, usmeno i pismeno da ste sposobni za komunikaciju
- Dobro poznavanje rad sa kompjuterom
- Sposobnost ispunjavanja zadataka pod opterećenjem, i određenje prioriteta

Ministarstvo Javne Uprave dočekuje aplikacije iz svih osoba muškog i ženskog pola iz svih zajednica.

#### Uslovi učesnika konkursa :

Pravo aplicirani imaju svih građani Republike Kosova koji imaju puno pravnu sposobnost za delovanje civilnih i političkih prava, i ima potrebnu profesionalnu edukativna priprema i sposobnost za obavljanje dužnosti, i koji imaju fizičke sposobnosti, potrebni za određenu poziciju.

**Datum zatvaranje konkursa :** Konkurs je otvoren 5 kalendarskih dana od dana objavljivanja na web sajt MJU- ve i dnevnoj štampi.

**Podnošenje zahtjeva :** Prijave za aplicirani mogu dobiti na recepciji MJU- ve, Kancelarija br.320 III- sprat ili u web sajt MJU- ve u adresi <http://map.rks-gov.net/> i dostavljaju u Diviziju Ljudske Resurse na adresu: Dom štampe Rilindja III- sprat Br. Kancelarije 320 - Priština, svakog radnog dana od 8:00 - 16:00.časova. Za detaljnije informacije možete kontaktirati na br. Tel. 038/200 30 002.

**Uz aplikaciju treba priložiti i:** kopiju lične karte, kopija kvalifikacione dokumentacije, kao i druga potrebna dokumenta prema konkursu.

Datum održavanje intervjuja za kandidate koji ispunjavaju uslove predviđene u ovom konkursu, bi će objavljen samo u službenom web sajt Ministarstvo Javne Uprave.





RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Prishtinë



## Njoftimi për shprehje të interesit

Shkolla: SHMU "7 Shtatori"

Komuna: Pejë

Data: 11.07.2018

Emri i kontratës: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie në gjuhën Shqipe dhe Boshnjake

Numri i kontratës: ESIP/C1.3/153 - ESIP/SDG/153-CS/-1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe SHMU "7 Shtatori" fshati Vitomericë në Pejë.

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

## 1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

- Aftësim i mësimdhënësve në operimin me mjete të TIK për mësimdhënësit e të dy gjuhëve: Shqipe dhe Boshnjake

## 2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën SHMU "7 Shtatori" në Vitomericë-Pejë më së largu deri më 19.07.2018.

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Emri i personit kontaktues:

Draga Babacic

Telefoni: 044 -112-690

E-mail: draga.babacic@gmail.com

## Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "SEFEDIN SMAKOLLI"

Komuna: Mitrovicë

Data: 11.07.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/151 -ESIP/SDG/151-CS/1.1	Trajnimit per Teknologji

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "SEFEDIN SMAKOLLI" Rashan, Mitrovicë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

## 1. Përshkrimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

## • Trajnimi për Teknologji

## 2. Kriteret minimale për kualifikim të Firmave Konsulente që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të interesimit për shërbime konsulente në adresën e "SEFEDIN SMAKOLLI" Rashan , Mitrovicë më së largu deri më 20.07.2018.

4. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë. Firmat Konsulente luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Driton Barani

Telefoni: 049/232-276

E-maili: driton\_barani@hotmail.com

## Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Liria"- Fortesë

Komuna: Rahovec

Data: 11.07.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/018 - ESIP/SDG/018-CS/1.1	Trajnimit i mësimdhënësve për TIK

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Liria"- Fortesë-Rahovec. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

## 1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

- Trajnimit i mësimdhënësve për TIK

## 2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën "Liria"- Fortesë-Rahovec, më së largu deri më 19.07.2018.

4. Termat e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Elhami Zhunij

Telefoni: 044269022

E-maili: elhami-dervishi@hotmail.com

## Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Tre Dëshmoret"

Komuna: Klinë

Data: 11 Korrik 2018

Emri i kontratës: Trajnim: Kurikula Arsimore

Numri i kontratës: ESIP/C1.3/149 - ESIP/SDG/149 - CS/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Tre Dëshmoret", fshati Jashanicë Komuna -Klinë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

## 1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

- Trajnimit i mësimdhënësve për njohuri të reja dhe shtesë mbi kurikulën arsimore me theks të veçantë vlerësimi formativ.

## 2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e shkollës SHFMU "Tre Dëshmoret" fshati Jashanicë Komuna e Klinës më së largu deri më 19 Korrik 2018 .

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Selman Havolli

Telefoni: 049 907 456

E-maili: selmanhavolli@hotmail.com





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018  
deri më 10.03.2018**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**